


EVROPA JUGLINDORE

RAPORTI I ZHVILLIMEVE

EKONOMIKE

Nr. 3

Nga Recesioni i Dyfishtë në Reforma të
Përsheptuara



18 dhjetor 2012




Njësia për Reduktimin e Varfërisë dhe Manaxhimin Ekonomik
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore



EVROPA JUGLINDORE: RAPORTI I ZHVILLIMEVE EKONOMIKE Nr.3

*Nga Recesioni i Dyfishtë në Reforma të
Përsheptuara*



18 dhjetor 2012

PËRMBAJTJA

1. ZHVILLIMET E FUNDIT EKONOMIKE, PERSPEKTIVAT DHE SFIDAT E POLITIKAVE EKONOMIKE	1
A. EUROZONA NË RECESION, RREZIQET E REJA GLOBALE	1
B. RRRITJA EKONOMIKE NË ETL6—NJË RECESION I DYFISHTË	4
C. TREGJET E PUNËS – NJË KRIZË E VAZHDUESHME.....	6
D. BORXHI TREGTAR DHE I JASHTËM- NË PËRKEQËSIM.....	14
E. POLITIKA FISKALE—DEFICITE, BORXHE, DHE PAGESA TË PRAPAMBETURA NË RRRITJE	20
F. SEKTORI FINANCIAR – VAZHDON TË MBETET I PREKSHËM.....	25
G. ÇËSHTJE STRUKTURE: MJEDISI NË ETL PËR TË BËRË BIZNES.....	29
H. ÇËSHTJE STRUKTURE: VALA E DYTË E PRIVATIZIMIT?.....	32
I. ÇËSHTJE STRUKTURE: DEFICITI I INFRASTRUKTURËS ENERGJETIKE	33
J. ETL6 PERSPEKTIVA PËR 2012–13	35
K. PËRSHPEJTIMI I REFORMAVE, MOBILIZIMI I FINANCIMEVE.....	36
2. MENAXHIMI I VULNERABILITETIT NDAJ TRONDITJEVE TË ÇMIMEVE TË USHQIMEVE NË ETL6.....	38
A. HYRJE	38
REFERENCAT	51

Figurat

Figura 1: Zhvillimet e Tregjeve Financiare	1
Figura 2: Prodhimi Industrial Global	2
Figura 3: Supozimet e Rritjes Ekonomike Globale.....	3
Figura 4: ETL6: Inflacioni-ICËK dhe Ushqimet (Përqindje).....	6
Figura 5 Ndryshimi në Nivelet e Papunësisë në ETL6, 2008 dhe 2012 (Pikë Përqindje)*	7
Figura 6: Nivelet e Papunësisë, ETL6 dhe BE10.....	7
Figura 7: Numri i të papunëve të regjistruar gjatë vitit 2011 (Janar 2011 = 100).....	8
Figura 8: Nivelet e Punësimit në ETL 6 (2011-2012), në përqindje.....	8
Figura 9: Ndryshimet në Pagat Nominale Mesatare Bruto (Janar 2011 = 100).....	9
Figura 10: Indeksi i Punësimit dhe Pagave Reale (Dhjetor 2010 = 100).....	10
Figura 11: Vështirësia në Rekrutimin e Punëtorëve në ETL6	12
Figura 12: Shpërblimet për Turnin e Natës dhe Punën gjatë Ditëve të Pushimit në ETL6	13

Figura 13: Kostot e Pushimit nga Puna dhe Kërkesat për Lajmërim	13
Figura 14: Treguesi i Eficiencës së Fuqisë Punëtore të FEB (WEF), 2012-2013.....	13
Figura 15: Eksportet (% e PBB)	14
Figura 16: Rritja e Eksporteve drejt EJT6 (% e PBB)	15
Figura 17: Rritja e Eksportit, EJT6 dhe BE (% e PBB).....	15
Figura 18: Eksportet dhe Rritja Ekonomike (%)	15
Figura 19: Rritja e Importit (%)	15
Figura 20: Rritja e Eksportit dhe Importit (% vit më vit)	16
Figura 21: CAD dhe Bilanci i Tregtisë (% e PBB).....	17
Figura 22: CAD sipas Vendeve (% e PBB).....	17
Figura 23: Remitancat e Punëtorëve 2008-2011 (% e PBB).....	17
Figura 24: Investimet e Huaja Direkte (neto, % e PBB).....	17
Figura 25: IHD për Frymë (neto, USD).....	18
Figura 26: Borxhi i Jashtëm i EJT6 (mesatar, % e PBB).....	19
Figura 27: Obligacione Totale Ndërkombëtare që Mbeten të Papaguara, Vende të Zgjedhura të EJT6 (milion USD)	19
Figura 28: Borxhi i Jashtëm Total Publik dhe Privat deri në Qeshor 2012 (% e PBB)	19
Figura 29: Rritja Ekonomike dhe Deficiti Struktural (jo i ponderuar, përqindje e PBB).....	21
Figura 30: Deficitet Struktural, 2005-11.....	21
Figura 31: Të ardhurat Reale të EJT6, 2008-12.....	22
Figura 32: Shpenzimet Reale të EJT6, 2008-12	22
Figura 33: Borxhi Publik dhe Garancitë Publike (% e PBB).....	24
Figura 34: Pretendimet Ndërkombëtare (% e PBB, 2012 T2)	25
Figura 35: Huatë në Monedhë të Huaj (% e totalit, 2012 T3).....	25
Figura 36: Rritja e Kreditimit (% e ndryshimit, T/T).....	27
Figura 37: Kreditë me Probleme (% e Kredive Totale) dhe Provigjioni (% e Kredive me Probleme, 2012 T2).....	27
Figura 38: Koeficientët e Mjaftueshmërisë së Kapitalit dhe Kthimit mbi Aktivët (% , 2012 T2).....	27
Figura 39: Raportet Hua-Depozitë (% , 2012 T2).....	27
Figura 40: EJT6 Lehtësia e të Bërit Biznes, 2011-13	29
Figura 41: Pikat e dobëta të klimës të biznesit 2012 në EJT6	31
Figura 42: Importet aktuale dhe të parashikuara të energjisë (GWh)	34
Figura 43: Prodhimi Industrial dhe Tregtia në BE.....	35
Figura 44: Cmimet e Drithërave dhe Vajrave Ushqimorë, Nominale dhe Reale në USD (2005=100)	39
Figura 45: Paqëndrueshmëria e Çmimit: Koeficienti Vjetor i Ndryshimit dhe Treguesi Theil për Cmimet e Ushqimeve, 1990-.....	40
Figura 46: Çmimet e Aksioneve të Misrit dhe Grurit (cent të USD për shinik)	41
Figura 47: Treguesit e çmimeve të ushqimeve për vendet e EJT; bazë vjetore	42
Figura 48: Vulnerabiliteti i Familjeve ndaj Tronditjeve Globale të Çmimit të Ushqimeve, BE dhe Evropë dhe Azi Qendrore.....	44
Figura 49: Përqindjet e Buxhetit Ushqimor sipas Decileve të Konsumit	45
Figura 50: Ndryshimi në Pjesën e Buxhetit për ushqim për shkak të një rritjeje prej 5% në Treguesin e Çmimit të Ushqimeve (pikë përqindjeje).....	47
Figura 51: Targetimi, mbulimi dhe sasia e ndihmës sociale në Ballkanin Perëndimor.....	48

Tabelat

Tabela 1: Europa Juglindore Gjashtë: Rritja Reale Ekonomike, 2009-12	4
Tabela 2: EJL6: Rritja Reale e Prodhimit Industrial sipas Tremujorëve (në përqindje, vit më vit).....	5
Tabela 3: EJL6: Rënia në Prodhimin Bujqësor Real në 2012.....	6
Tabela 4: Bilancet Fiskale të EJL6 2008-12 (% e PBB).....	20
Tabela 5: EJL6: Renditjet e Kredisë Sovrane ¹	24
Tabela 6: Treguesit Kryesorë Makroekonomik (projektimet e 2012, % e PBB) dhe Skemat e Sigurisë Financiare.....	28
Tabela 7: Privatizimet e lajmëruara në Ballkanin Perëndimor	32
Tabela 8: Rritja Globale dhe Rajonale.....	35
Tabela 9: Perspektiva e Rritjes e EJL6 për vitet 2012-13.....	36
Tabela 10: Vlerësimet e Ndryshimeve (Përqindje) të Çmimeve Botërore dhe Vendore të Ushqimeve dhe Kalimit	43
Tabela 11: Ndryshimi i Simuluar në Varfëri nga një Rritje prej 5 Përqind në Çmimet e Ushqimeve (Pikë përqindjeje)	46

Kutitë

Kutia 1: FIAT në Serbi: Industria e Makinave Kthehet në Ballkanin Perëndimor	5
Kutia 2: Rritja e Papunësisë në Serbi.....	7
Kutia 3: Raporti i Zhvillimeve Botërore mbi Vendet e Punës: Implikimet për Politikën në Tregun e Punës	11
Kutia 4: Rimbursimi i taksave dhe Shpenzimet e Papaguara: Shqetësim në Rritje	22
Kutia 5: Supozimet në Bazë të Vlerësimit të Ndikimit të Varfërisë	46

Ky raport nxirret dy herë në vit nga një ekip me ekonomistë të Departamentit të Uljes së Varfërisë dhe Menaxhimit Ekonomik të rajonit të Evropës dhe Azisë Qendrore në Bankën Botërore (ECA PREM). Ky dhe raportet e mëparshme mund të gjenden në faqen e internetit www.worldbank.org/eca/seerer . Ekipi i autorëve drejtohet nga Zeljko Bogetic (zbogetic@worldbank.org) dhe përfshin anëtarët e mëposhtëm me detyra tematike: Dilek Aykut (zhvillimet globale dhe perspektiva), Alexandru Cojocar (shënim i veçantë tematik për çmimet e ushqimeve); Damir Čosić (sektori financiar; Bosnje dhe Hercegovinë); Simon Davies (fiskale dhe borxhi), Mike Edwards (sektori financiar); Agim Demukaj (Kosovë); Borko Handjiski (tregjet e punës, Bosnja dhe Hercegovina); Caterina Ruggeri Laderchi (shënim i veçantë tematik për çmimet e ushqimeve) ; Erjon Luçi (menaxher i bazës së të dhënave të EJL6, Shqipëri), Sanja Madzarević-Sujster (reformat strukturore të EJL6, Mali të Zi), Lazar Sestović (ekonomia reale, Serbi); Bojan Shimbov (privatizimi, të bërit biznes, IRJ e Maqedonisë) dhe Kenneth Simler (çështje speciale për çmimet e ushqimit). Carolina Sanchez-Paramo dhe Indhira Vanessa Santos kontribuan në seksionin mbi tregjet e punës. Javier Suarez kontribuoi në kutinë mbi mësimet e privatizimeve.

Shpërndarja e raportit si dhe marrëdhëniet me jashtë dhe me median u realizuan nga një ekip i Departamentit të Marrëdhënieve me Jashtë që përfshin Lundrim Aliu, Denis Boskovski, Ana Gjokutaj, Jasmina Hadzić, Andrew Kircher, Vesna Kostić, Mirjana Popović, John Mackedon, Krystin Schrader, and Dragana Varezić.


Ekipi përfitoi nga udhëzimet dhe këshillat e Satu Kahkonen (menaxher sektori, ECA PREM2) dhe Yvonne Tsikata (drejtor, ECA PREM). Falenderime me mirënjohje për diskutimet me Abebe Adugna (ECSPE) dhe Juan Zalduendo (ECAVP).

Në këtë raport, "Evropa Jug-Lindore" i referohet gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (EJL6): Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, IRJ e Maqedonisë, Mali i Zi dhe Serbia.

PËRMBLEDHJE

Pas dy viteve rikuperimi të brishtë nga recesioni global, si grup gjashtë vendeve të Evropës Juglindore (EJL6) - Shqipëria, Bosnje dhe Hercegovina (BiH), Kosova, IRJ e Maqedonisë, Mali i Zi, dhe Serbia - janë duke përjetuar një recesion të dyfishtë në vitin 2012. Përkeqësimi i kushteve të jashtme, ndikimi i dimrit të ashpër në aktivitetin ekonomik, dhe një rritje e vazhdueshme e papunësisë në fillim të vitit patën efekt negativ mbi konsumin, investimet dhe eksportet. Rreziqet e evidentuara në raportin e Qershorit janë materializuar. Rimëkëmbja e kreditimit dhe konsolidimi fiskal janë të kërcënuara. Kreditë me probleme (NPL) – të cilat vetëm disa muaj më parë u mendua se po stabilizoheshin - janë përsëri në rritje. Si rezultat, mjedisi, brenda dhe jashtë rajonit, është bërë shumë më i vështirë për tu menaxhuar, dhe kompensimet e politikave ekonomike të nevojshme për të stabilizuar ekonominë dhe ringjallur rritjen ekonomike janë më të ashpra.

Pas rritjes me rreth 2 për qind në vit në 2010-11, PBB reale e kombinuar e EJL6 do të tkurret me 0,6 për qind në vitin 2012, me rënie deri në 2 për qind të prodhimit real në Serbi. Është bërë gjithashtu e qartë se edhe në rrethanat më të mira, rruga për rimëkëmbjen e qëndrueshme do të jetë e vështirë: rritja në vitin 2013 tani pritët të jetë mesatarisht 1.6 për qind dhe rreziqet mund të jenë tepër të mëdha. Retë në horizontin e vitit 2013 janë ndikimi global i “greminës fiskale” të SHBA, rimëkëmbja e lëkundur e Eurozonës dhe çmimet e larta të lëndëve të para - rreziqe ndaj të cilave të gjitha vendet e EJL6 janë shumë të prekshme. Gjithashtu shqetësuese për popullsinë e rajonit do të jetë rreziku i një goditje të re të çmimeve të ushqimit, që mund të përkeqësojnë varfërinë dhe të ushtrojnë presion mbi shtresën e mesme.



Në këtë situatë të brishtë, Serbia, Shqipëria dhe në veçanti Mali i Zi do të duhet të vazhdojnë reduktimin e deficiteve fiskale dhe reduktimin e borxhit, në të njëjtën kohë që duhet të vazhdojnë të përmirësojnë klimën e investimeve dhe të reformojnë tregjet e punës dhe sektorin publik. Në të gjitha vendet e EJL6, pagesat e prapambetura të sektorit publik përbëjnë një sfidë të veçantë për menaxhimin fiskal dhe për sektorin privat, ndërkohë që ka ende reforma strukturore të tjera të papërfunduara.

Pas dy vitesh krize të thellë dhe një rimëkëmbje të ngadaltë, me një papunësi dhe varfëri në rritje, dhe një recesion në vazhdim – me gjithë përpjekjet më të mira për konsolidim fiskal dhe reforma strukturore, të cilat duhet të vazhdojnë - ekziston rreziku që vendet EJL6 të jenë futur në një rreth vicioz që përforcon ciklin e shtrëngimit afatgjatë, të rritjes ekonomike të ulët ose dhe negative, të borxhit të lartë, madje dhe të rreziqeve më të larta të trazirave sociale. Për të shmangur këtë, në këtë raport argumentohet se

qeveritë e EJL6 duhet të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të përshpejtuar reformat fiskale dhe strukturore. Këto vende e kanë konsumuar tërësisht hapësirën e tyre fiskale dhe i kanë reduktuar investimet publike (përveç Kosovës, që përbën një përjashtim) në një fraksion të asaj që nevojitet për të ruajtur stokun e kapitalit publik në infrastrukturën bazë. Investimet private janë tkurrur nga mungesa e investimeve publike plotësuese produktive, rimëkëmbja e ngadaltë e kreditimit dhe kërkesa e ulët e brendshme. Kërkesa e jashtme është minimale, dhe eksportet janë jo vetëm të ulëta, por ato pengohen për tu bërë motor i shpejtë i ri i rritjes ekonomike nga probleme të infrastrukturës, financave, dhe mangësi të tjera.

Ky raport argumenton se është e nevojshme para së gjithash të ndiqet një politikë më intensive reformash për të reduktuar borxhin publik dhe të përshpejtohen reformat strukturore, veçanërisht në qeverisjen e sektorit publik, klimën e investimeve, dhe tregjet e punës. Vendet e EJL6 duhet të përgatiten dhe për goditje të reja çmimesh të ushqimit, duke pasur parasysh prekshmërinë e tyre.

Nëse këto reforma të përshpejtuara materializohen, atëherë mbështetja e jashtme – e koordinuar mirë dhe e fokusuar për rajonin si një të tërë, jo thjesht për vende të veçanta – nga BE dhe institucionet financiare ndërkombëtare (IFI) mund të ndihmojë në lehtësimin e tranzicionit drejt një rritje më të qëndrueshme në periudhën afat mesme.

Në Nëntor të vitit 2012, Banka Evropiane e Investimeve, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Banka Botërore njoftuan financimin e 30 miliard euro për vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore gjatë dy viteve të ardhshme. Për vendet e EJL6, kjo iniciativë që vjen në kohën e duhur ka të ngjarë të zbatohet nëpërmjet Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor(WBIF), si dhe burime të tjera të IFI. Instrumenti për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA) është gjithashtu i rëndësishëm sidomos për reformat institucionale dhe zhvillimin rural. Nëpërmjet fokusimit të saj në infrastrukturën me rëndësi të rajonale (hekurudha, autostrada, energji, dhe gaz) dhe në vendet e punës dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, efienca e investimeve, rritja ekonomike dhe punësimi mund të zgjerohen ndjeshëm. Megjithatë, financimi shtesë për rritje ekonomike dhe vende pune mund të jetë efektiv vetëm nëse shoqërohet me reforma të intensifikuara fiskale dhe strukturore, veçanërisht në fushat e klimës së investimeve, tregjeve të punës, dhe qeverisjes.

1. ZHVILLIMET E FUNDIT EKONOMIKE, PERSPEKTIVAT DHE SFIDAT E POLITIKAVE EKONOMIKE


A. EUROZONA NË RECESION, RREZIQET E REJA GLOBALE

Pas disa muajve ngadalësimi të aktivitetit ekonomik si rrjedhojë e trazirave në tregjet financiare në tremujorin e dytë, aktiviteti ekonomik global po e rimerr veten përsëri - kryesisht në vendet në zhvillim. Por rimëkëmbja modeste është e brishtë. Të dhënat e fundit tregojnë se rritja e prodhimit industrial në dy ekonomitë më të mëdha botërore, SHBA dhe Japoni, është në ngadalësim. Për shkak të dobësisë në mesit të vitit, parashikimet për vitin kalendarik të rritjes së PBB globale po konsiderohen të ulen me rreth 0.2 pikë përqindjeje për vitin 2012 duke arritur në 2.3 për qind dhe me 0.4 pikë përqindjeje për vitin 2013 duke arritur në 2.6. Rreziqet e rimëkëmbjes kanë të bëjnë me vështirësitë e zbatimit të konsolidimit fiskal të Eurozonës; zgjidhjen e "greminës fiskale," dhe rrezikun e rënies të pakontrolluar të nivelit të lartë të investimeve të Kinës. Situata bëhet më e komplikuar me rezervat e ulëta të misrit dhe grurit që mund të rezultojnë në çmime akoma më të larta të ushqimeve, me pasojë të rënda për të varfrit.

Që prej paqëndrueshmërisë të tremujorit të dytë të vitit 2012, tensionet e tregjeve financiare globale janë lehtësuar ndjeshëm, kryesisht falë shpalljes së masave të Bankës Qendrore Evropiane (BQE) për të mbrojtur Eurozonën, megjithatë, ekonomia globale ndeshet ende me rreziqe të konsiderueshme. Në fillim të Shtatorit, me nisjen e programit të BQE për blerjen e obligacioneve dhe të vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë në favor të Mekanizmit të Stabilitetit Evropian (ESM), rreziku i një krize akute u zvogëlua në mënyrë të konsiderueshme, dhe kostot e huamarrjes për vendet me spread të lartë si Italia dhe Spanja ranë ndjeshëm (Figura 1). Diferencat e spredeve të obligacioneve të tregjeve të reja (EMBIG) kanë rënë me 80 pikë bazë (bps) që prej Qershorit duke arritur nivelet e tyre mesatare afatgjata (rreth 310 bps). Gjithashtu që prej fillimit të Qershorit u rritën edhe tregjet globale të kapitalit: deri më tani për vitin 2012 letrat me vlerë janë rritur me 10,7 për qind në vendet me të ardhura të larta dhe 8.1 për qind në vendet në zhvillim.

Gjithashtu, flukset bruto të kapitalit duket se po rimëkëmben. Flukset e kapitalit drejt vendeve në zhvillim (emetimet e obligacioneve në tregjet ndërkombëtare, kreditë bankare sindikale ndër-kufitare, dhe financimet private të kapitalit), të cilat ranë me 30-40 për qind nga fundi i tremujorit të dytë në Qershor, në tremujorin e tretë u rikthyen në nivelet e tremujorit të parë. Me zbutjen e tkurrjes së kreditimit të Eurozonës, huatë bankare sindikale për vendet në zhvillim pothuajse u dyfishuan në Gusht, megjithëse mbeten mbi 30 për qind nën nivelin e 2011. Pas qetësimit sezonal të flukseve të

Figura 1: Zhvillimet e Tregjeve Financiare




kapitalit në Gusht, në Shtator flukset bruto tejkaluan çdo muaj tjetër që prej vitit 2007 duke arritur një vlerë totale prej 408 miliard US\$, një rritje e lehtë krahasuar me 2011. Rritja në emetimet e obligacioneve të vendeve në zhvillim kompensoi rënien e huave bankare sindikale dhe financimet private të kapitalit.

Vendet në zhvillim kanë kryesuar përmirësimin e aktivitetit ekonomik (Figura 2). Prodhimi industrial u rrit me një ritëm vjetor prej 5.8 për qind në T3. PBB e Kinës u rrit me 9.1 për qind (3m/3m, terma vjetore), nga 8.2 për qind në T2, i udhëhequr nga sektori i shërbimeve. Midis vendeve me të ardhura të larta situata është me shumë nuanca. Në Shtetet e Bashkuara pati një përsheptim në T2 (2.7 për qind 3m/3m vjetore) i mbështetur nga rritje e qëndrueshme e investimeve në ndërtim, por ajo u shoqërua nga një tkurrje e papritur në T3 (-3 për qind 3m/3m vjetore). Në Eurozonë prodhimi industrial u rrit në T3, por jo në masë të mjaftueshme për të shmangur një kontraktim të PBB për tremujorin (në -0.1, 3m/3m).

Por, treguesit kryesorë sugjerojnë një tablo të përzierë për tremujorin e fundit të vitit 2012. Vlerat e fundit të Indeksit të Menaxherëve të Blerjeve (PMI) sugjerojnë se prodhimi është më i shëndetshëm në T4 për Shtetet e Bashkuara të Amerikës (por duhet theksuar se PMI është kryer para uraganit Sandy) dhe për vendet në zhvillim si Kina, Brazili, Indonezia, India, Rusia dhe Turqia, shumë prej të cilave kanë përfituar nga një lehtësim i kohëve të fundit i normave bazë të interesit. Edhe pse aktiviteti industrial i Eurozonës u stabilizua në T3, PMI për dy zonat, qendrore dhe periferike të eurozonës sugjeron tkurrje të mëtejshme në T4; në fakt, prodhimi industrial kishte filluar të binte që në Shtator. Gjithashtu, vazhdimi i rënies së PMI të Japonisë sugjeron se ajo mund të hyjë në një recesion teknik në T4.

Figura 2: Prodhimi Industrial Global




Për rrjedhojë, parashikimet e rritjes globale janë duke u rishikuar në ulje, veçanërisht për vitin 2013 (Figura 3). Ndërsa aktiviteti industrial duket se ka arritur nivel minimal në Korrik, sondazhet sentimentit të biznesit dhe dinamika e stokeve sugjerojnë se rritja është e ulët në T4. Por nga ajo që ka ndodhur deri më tani, duket se parashikimet e Bankës Botërore në “Perspektivat Ekonomike Globale” në

Qershor 2012, mund të korrigjohen në ulje. Projektionet paraprake të rritjes ekonomike globale janë rreth 2.3 për qind në vitin 2012, dhe 2.4 për qind në vitin 2013

Edhe pse rreziqet e një krize të re dhe akute Evropiane janë zbutur disi, çmimet e larta të ushqimit, pasiguria globale, si dhe ngadalësimi i Kinës janë ende të dukshme dhe prezentë. Ekzistojnë disa rreziqe specifike që errësojnë perspektivën e rimëkëmbjes ekonomike. Për shembull:

Figura 3: Supozimet e Rritjes Ekonomike Globale



- Ka një sërë pasigurish. Megjithëse recesioni dhe konsolidimi fiskal në Evropë përbëjnë rreziqe të mëdha, aktualisht skenari bazë për Evropën është se tensionet do vazhdojnë të zbuten gradualisht me zbatimin e rregullimeve dhe masave të reja institucionale.
- Gjithashtu, sfidat fiskale të SHBA kanë filluar të bëhen shqetësimi kryesor. Nëse legjislacioni aktual nuk ndryshon, do të çoi në një shtrëngim fiskal prej 4.6 për qind të PBB në vitin 2013, që mund të shkaktojë një recesion në Shtetet e Bashkuara. Parashikimet bazë supozojnë një shkurtim më të vogël rreth 1.5 për qind të PBB.
- Edhe pse kërkesa Kineze mund të rimëkëmbet, njoftimi i shpenzimeve më të mëdha në infrastrukturë, heq shpresën që ajo mund të mbështesë rritjen ekonomike globale për pjesën e mbetur të vitit 2012.
- Për më tepër janë dhe çmimet e ushqimeve: Gjatë kësaj vere çmimet e grurit dhe misrit u rritën me rreth 40 për qind për shkak të thatësirave dhe probleme të tjera të motit në SHBA dhe në Evropë. Megjithëse ende nuk ka mungesa serioze furnizimi, çmimet e larta mund të kenë rrjedhoja serioze buxhetore për vendet e varura nga importi i drithërave. Një përsëritje e rritjes së çmimeve si në vitin 2010 mund të dëmtojë rritjen ekonomike të tregjet në zhvillim dhe mund të kufizojë hapësirën e lehtësimit të mëtejshme të politikave ekonomike.

B. RRITJA EKONOMIKE NË EJL6¹—NJË RECESION I DYFISHTË

Pas një rritje mesatare vjetore prej vetëm 2 për qind në vitin 2010 dhe 2011, dhe duke reflektuar zhvillimet e Eurozonës, vendet e EJL6 hynë përsëri në recesion në gjysmën e parë të vitit 2012. Aktiviteti ekonomik rajonal, i udhëhequr nga Serbia, e cila përbën pothuajse gjysmën e PBB të EJL6, u dobësua pjesërisht për shkak të dimrit të ashpër, por edhe për shkak të zvogëlimit të ndjeshëm të kërkesës, së jashtme dhe të brendshme (Tabela 1).

Tabela 1: Europa Juglindore Gjashtë: Rritja Reale Ekonomike, 2009-12

	2009	2010	2011	2012 Gj1	2012 Gj2 (proj)	2012 (proj)
ALB	3.3	3.5	3.0	1.0	0.6	0.8
BIH	-2.9	0.7	1.3	-0.2	0.2	0.0
KOS	2.9	3.9	5.0	3.6	3.6	3.6
MKD	-0.9	2.9	2.8	-1.1	1.0	0.0
MZI	-5.7	2.5	2.5	-0.9	1.0	0.2
SRB	-3.5	1.0	1.6	-1.6	-2.3	-2.0
EJL6	-1.8	1.8	2.2	-0.6	-0.5	-0.6
BE10	...	2.0	3.1	1.3	..	0.9

Burimi: Zyrat kombëtare të statistikave të vendeve të EJL6 dhe stafi i Bankës Botërore. Mesataret janë të ponderuara me PBB

Pavarësisht recesionit të rajonit, rritja ekonomike në vendet individuale të EJL6 kishte ndryshime mëdha. Serbia dhe IRJ e Maqedonisë kishin rënien më të madhe ekonomike me rreth 1.6 dhe 1 për qind, respektivisht, në gjysmën e parë të vitit 2012. Kosova përbën një përjashtim, prodhimi i së cilës vazhdon të nxitet nga investimet e larta publike në autostrada, dhe ekonomia e Shqipërisë u rrit me 1 për qind e mbështetur në kërkesën e brendshme. Këto zhvillime u diktuan nga ulja e eksporteve dhe investimeve; papunësia e lartë nuk lejoi rritjen e konsumit. Me gjithë rimëkëmbjen graduale të pritur në gjysmën e dytë të vitit, EJL6 si grup do të mbetet në recesion për 2012 si vit. Papunësia – niveli më i lartë i papunësisë rajonale në Evropë, mesatarisht me rreth 25 për qind (duke përjashtuar Kosovën papunësia e së cilës kalon 40 për qind, pjesërisht e zbutur prej punësimit informal) – do të vazhdojë të rritet.

Rimëkëmbja është ngadalësuar nga performanca e dobët industriale. Në të gjithë rajonin prodhimi industrial ka qenë në rënie të vazhdueshme për tre tremujorë rresht, nga T4 2011 deri në T2 2012. Rënia ishte më e madhe në gjysmën e parë 2012, kur shumë fabrika duhet të mbylleshin për disa javë për shkak të dimrit jashtëzakonisht të ftohtë; thatësisë në dimër dhe mungesës së fuqisë hidrike si rezultat i saj; dhe një rënie në kërkesën për eksportet industriale. Si rezultat, rritja mesatare e ponderuar e prodhimit industrial në tremujorin e parë ishte -10.1 për qind. Rënia më e ndjeshme ishte në Shqipëri (-20.3), e ndjekur nga Mali i Zi (-14.7 për qind) (Tabela 2).

¹ EJL6 janë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, IRJ e Maqedonisë, Mali i Zi, dhe Serbia.

Tabela 2: EJL6: Rritja Reale e Prodhimit Industrial sipas Tremujorëve (në përqindje, vit më vit)

	2011				2012	
Vendi ²	T1	T2	T3	T4	T1	T2
Shqipëria	11.1	-5.4	5.6	-9.7	-20.3	6.4
Bosnja dhe Hercegovina	11.1	6.2	6.0	2.9	-9.4	-4.1
Kosova	13.8	5.3	1.4	-4.7	-8.5	-5.6
Maqedonia, FYR	-10.2	-21.0	3.6	-11.6	-14.7	1.9
Serbia	5.7	3.8	-1.8	0.4	-6.4	-3.1
<i>Mesataret</i>						
E thjeshtë	6.3	-2.2	3.0	-4.6	-11.8	-0.9
E ponderuar me PBB	7.8	1.6	1.8	-2.1	-10.1	-1.7

Burimi: Zyrrat kombëtare të statistikave dhe përllogaritjet e stafit të Bankës Botërore

Ndërsa prodhimi industrial rajonal për të gjitha vendet së bashku është ende në rënie, ka shenja të rimëkëmbjes. Rënia e prodhimit ishte mjaft më e vogël në tremujorin e dytë, vetëm -1.7 për qind (në terma vjetore). Përveç kësaj, riaktivizimi i fabrikave të mbyllura më parë ndihmoi për të rritur prodhimin në Shqipëri dhe Mal të Zi. Nga ana tjetër, industria u tkurr me 5.6 për qind në Maqedoni, me 3.1 për qind në Serbi, dhe me 4.1 për qind në BIH. Por rritja e prodhimit nga ana e FIAT do të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme jo vetëm në rritjen ekonomike të Serbisë, por edhe në rritjen e prodhimit industrial në të gjithë rajonin për shkak të shkallës së saj.

Kutia 1: FIAT në Serbi: Industria e Makinave Kthehet në Ballkanin Perëndimor

Hapja e fabrikës së madhe të FIAT në Serbi dhe investimet e fundit të huaja në prodhimin e pjesëve të këmbimit të makinave në IRJ të Maqedonisë, lajmërojnë rikthimin gradual të industrisë së makinave në Ballkanin Perëndimor dhe premtojnë të rigjallërojnë disa zona të industrisë së saj. FIAT dhe Qeveria e Serbisë kanë krijuar një sipërmarrje të përbashkët - Fiat Automobili Srbija Ltd - në të cilën FIAT zotëron 66 për qind dhe Serbia 34 për qind të kapitalit. Serbia ka investuar kryesisht në natyrë (toka, ndërtesat ekzistuese, dhe përmirësime të infrastrukturës në qytetin e Kragujevcit, rrugët e hyrjes dhe hekurudhat; furnizim më të mirë me energji elektrike, etj.) Deri më tani, është hapur dhe është vënë në punë një linjë prodhimi (ndërkohë që janë planifikuar tre të tilla), dhe pritet të prodhojë 30.000 makina (modeli 500L) në vitin 2012, dhe rreth 150.000 në vitin 2013. Të ardhurat vlerësohet të jenë rreth 400 milion euro për vitin 2012 dhe më shumë se 2 miliard euro në vitin 2013 (rreth 6 për qind e PBB së Serbisë), edhe pse kjo do të jetë kryesisht nga modeli 500L, FIAT planifikon të fillojë edhe prodhimin e Punto, megjithëse vetëm me rreth 10.000 njësi si fillim.

Përveç problemeve të industrisë, të korrat jashtëzakonisht të këqija në të gjithë Ballkanin kufizuan prodhimin bujqësor, duke kontribuar në recesionin e përgjithshëm si edhe në presionet mbi çmimet e ushqimeve vendase (Tabela 3). Prodhimi bujqësor në të gjithë rajonin vuajti gjatë gjithë vitit nga moti ekstrem. Së pari, temperaturat e dimrit arritën në nivele të ulëta rekord, shoqëruar me thatësi. Pastaj në verë rajoni, si shumë pjesë të tjera të botës, u përball me një thatësi të rëndë. Si rezultat, prodhimi bujqësor u zvogëlua shumë. Rezultatet për tremujorin e tretë mund të jenë veçanërisht të këqija për vendet që kanë përqendruar aktivitetet e tyre bujqësore në prodhimin e drithërave dhe të frutave. Serbia, dhe deri diku BiH, u goditën më rëndë. Në gjysmën e parë të vitit Serbia pati rënie të vlerës së

² Kosova nuk ka të dhëna periodike të shpeshta për prodhimin industrial

shtuar bujqësore me 18 për qind. Si rezultat, inflacioni i ushqimeve dhe i IÇK në SEE6 ndërpreu prirjen rënëse që kishte filluar në Mars 2012 (Figura 4).

Tabela 3: EJL6: Rënia në Prodhimin Bujqësor Real në 2012


Prodhimi bujqësor, normat e rritjes tremujore (% , vit mbi vit)

	T1	T2
ALB	4.5	5.6
BIH ¹	-4.5	-4.1
MKD	3.3	0.0
MZI	-10.0	30.0
SRB	-19.0	-17.2

¹ Të dhënat disponohen vetëm për Republikën Serbe.

Shënim: Për të gjitha vendet, përveç Maqedonisë, indekset bazohen në vlerën e shtuar me çmime konstante. Për Malin e Zi, baza është prodhimi fizik. Për Maqedoninë tr/tr të zhveshura nga efektet sezonale

Figura 4: EJL6: Inflacioni-IÇK dhe Ushqimet (Përqindje)




Burimi: Zyrrat kombëtare të statistikave të EJL6

C. TREGJET E PUNËS – VAZHDOJNË NË KRIZË

Në kushtet e recesionit të dyfishtë, papunësia në EJL6 vazhdon të rritet. Tre vjet pasi kriza globale goditi rajonin, tregjet e punës në shumicën e ekonomive të saj vazhdojnë ende të përkeqësohen. Papunësia në Serbi dhe Bosnje dhe Hercegovinë në vitin 2012 është shumë më e lartë se në vitin 2008 (Figura 5). Niveli i papunësisë në Serbi u rrit me 11 pikë përqindjeje-një humbje e pashembullt e vendeve të punës (Kutia 2) - ndërsa në Bosnje dhe Hercegovinë niveli u rrit me gati 5 pikë përqindje. Nga të gjitha vendet në zhvillim të Evropës dhe Azisë Qendrore, vetëm tre Shtetet Balltike kanë shënuar një rritje të nivelit të papunësisë deri në 11-12 pikë përqindjeje gjatë krizës globale, por në vitin 2011 të tre këto vende arritën të ulin nivelet e papunësisë me 2.5-4.5 pikë përqindjeje. Për më tepër, humbja e vendeve të punës në vendet Balltike erdhi si rezultat i recesionit të fortë ekonomik dhe rënies dyshifrore në prodhim. Në të kundërt, tkurrja e prodhimit në Serbi dhe Bosnje dhe Hercegovinë ka qenë shumë më e butë, por përkeqësimi i tregut të punës ka qenë shumë më i zgjatur. Niveli i papunësisë në Mal të Zi është edhe më i lartë se në periudhën para krizës, edhe pse ndikimi ka qenë më pak i zyrtarë. Shqipëria ndoshta bën pjesë në të njëjtin grup, me kthimin e disa emigrantëve nga Greqia që shtojnë papunësinë, por të dhëna nga anketat e fuqisë punëtore nuk disponohen. Maqedonia dhe Kosova kanë patur performancë më të mirë, pasi rritja e këtyre ekonomive në vitet e fundit ka qenë e moderuar.


Figura 5 Ndryshimi në Nivelet e Papunësisë në EJT6, 2008 dhe 2012 (Pikë Përqindje)*



Burimi: Anketimet e fuqisë punëtore (AFP) të zyrave kombëtare të statistikave

*Të dhënat më të fundit e AFP e vitit 2011 nuk janë të disponueshme për Kosovën dhe Shqipërinë.

Figura 6: Nivelet e Papunësisë, EJT6 dhe BE10



Burimi: Anketimet e Fuqisë Punëtore (LFS) të Zyrave Kombëtare të Statistikave

Shënim: Të dhënat për Kosovën për vitin 2010 nuk janë të disponueshme; të dhënat për Shqipërinë nga burime administrative. BE10 përfshin Bullgarinë, Republikën Çeke, Estoninë, Hungarinë, Letoninë, Poloninë, Rumaninë, Republikën Sllovaqe, dhe Slloveninë. BE11 përfshin gjithashtu Kroacinë.

Papunësia e lartë mbetet ende një sfidë e madhe ekonomike dhe sociale për rajonin (Figura 6). Kosova, me nivel të papunësisë 45 për qind, Maqedonia, 32 për qind, dhe Bosnje dhe Hercegovina dhe Serbia me rreth 28 për qind, bëjnë përjashtim jo vetëm për Evropën në tërësi, por edhe në rang global. Sipas Treguesve të Zhvillimit Botëror të Bankës Botërore, vetëm pak vende në botë kanë nivel papunësie më të lartë se 25 për qind. Siç është përmendur në botimet e mëparshme të këtij raporti, papunësia e moshave të reja dhe ajo afatgjatë janë probleme veçanërisht shqetësuese për rajonin. Një rënie e tejzgjatur ekonomike do të rriste problemin tashmë kronik të papunësisë afatgjatë.

Kutia 2: Rritja e Papunësisë në Serbi

Papunësia në Serbi pësoi një rritje të menjëhershme të madhe si pasojë e krizës ekonomike 2008-9 dhe vazhdoi të rritej gjatë 2010-2011, edhe pse ekonomia iu rikthye një rritje të ulët pozitive; me kthimin në recesion në vitin 2012, ka të ngjarë që papunësia të përkeqësohet më shumë përpara se të përmirësohet. Vlerësimet nga paneli i Anketimeve të Fuqisë Punëtore (SFP) sugjerojnë se përqindja e të papunëve në popullsinë e përgjithshme aktive (mosha 15 +) u rrit nga 15.8 për qind në Prill 2009 në 19.5 për qind në Prill 2010, 22.5 për qind në Prill 2011, dhe 23.7 për qind në Nëntor 2011.

Inaktiviteti është gjithashtu në rritje. Gjatë periudhës 2009-11, jo vetëm që u rrit numri i të papunëve me më shumë se 250.000, por edhe popullsia ekonomikisht aktive pësoi një rënie prej 340.000. Vlerësimet e bazuara në panelin AFP tregojnë se inaktiviteti në punë ishte veçanërisht i lartë në fillim të krizës globale, dhe një e katërta e të punësuarve kaloi nga punësimi informal në inaktivitet ndërmjet Prill 2008 dhe Prill 2009. Më shumë se 20 për qind e të papunëve në Prill 2008 e kishin braktisur plotësisht tregun e punës në Prill 2009.

Gjetja e punës për të papunët është jashtëzakonisht e vështirë. 85 për qind e të papunëve në Prill 2009 nuk kishte gjetur ende punë në Prill 2010, dhe vetëm 9 për qind kishte arritur të punësohej, më së shpeshti


në sektorin formal. Gjithashtu, 83 për qind e të papunëve në Prill 2010 ishin ende të papunë në prill 2011, ndërsa pjesa e atyre që kalonin në punësim ishte gjithashtu më pak se 10 për qind.

Burimi: Banka Botërore (2012c), bazuar në të dhënat e panelit AFP të Serbisë.

Të dhënat nga burime administrative mbi numrin e regjistruar të të papunëve mbështesin analizën e mësipërme dhe lejojnë monitorimin e prirjeve për vitin 2012 në të gjitha vendet EJL6 (Figura 7).


Të dhënat nga burimet administrative (zakonisht Zyrat e Punësimit) për personat e regjistruar si të papunë janë më pak të besueshme se të dhënat AFP dhe nuk janë të krahasueshme brenda rajonit. Megjithatë, këto të dhëna tregojnë një divergjencë në performancë të ngjashme me ato të AFP. Numri i të papunëve të regjistruar në vitin 2012 në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Shqipëri është më i lartë se në vitin 2011. Megjithatë, numri i të papunëve të regjistruar në Maqedoni, Mal të Zi, dhe Kosovë ka pësuar ulje në vitin 2012 – megjithëse një pjesë e ndryshimit mund të shpjegohet pjesërisht prej ndryshimeve në rregulloren e punës në Maqedoni dhe Kosovë³.

Figura 7: Numri i të papunëve të regjistruar gjatë vitit 2011 (Janar 2011 = 100)



Burimi: Zyrat Kombëtare të Statistikave

Figura 8: Nivelet e Punësimit në EJL 6 (2011-2012), në përqindje



Burimi: Anketimet e Fuqisë Punëtore të Zyrave Kombëtare të Statistikave

Në përgjithësi, norma e pjesëmarrjes në tregun e punës në vendet e EJL6 ka qenë më e ulët se në vendet e BE, duke filluar nga 44 për qind në Bosnje dhe Hercegovinë në 56 për qind në Maqedoni⁴. Norma e pjesëmarrjes mbeti relativisht e pandryshuar ndërmjet viteve 2011 dhe 2012. Ndryshimi më i madh u vu re në Malin e Zi: një rritje prej 0.5 pikë përqindjeje, e pasqyruar nga rritja e nivelit të punësimit. Nga ana tjetër, Serbia ka pasur rritje të pjesëmarrjes në tregun e punës gjatë tre viteve të fundit. Kjo tërheqje e fuqisë punëtore tregon për një "papunësi të fshehur" përtej shifrave zyrtare.

Të dhënat e punësimit të AFP të disponueshme për vitin 2012 japin një panoramë të përzier në rastin më të mirë (Figura 8). Në nivel rajonal, nivelet e punësimit janë më të larta në Mal të Zi dhe më të ulëta në Bosnje dhe Hercegovinë. Punësimi vazhdon të rrëshqasë në Serbi dhe në Bosnje-Hercegovinë. Serbia ka humbur rreth 680,000 vende pune që nga viti 2008 – që përbën 30 për qind të punësimit të


³ Ofrimi i sigurimit shëndetësor falas në Maqedoni u shkëput nga statusi i individëve në tregun e punës, dhe autoritetet po paraqesin masa shtesë për të kanalizuar e regjistrimin e papunësisë. Kosova prezantoi një bazë të dhënash dixhitale për të papunët e cila bëri të mundur pastrimin e dosjeve të vjetëruara.

⁴ Përdorimi i "moshës 15 dhe lart" për të përcaktuar popullsinë aktive.

përgjithshëm në vitin 2012. Këto humbje duket se janë të përqendruara në sektorët e bujqësisë, financës dhe ndërtimit të cilët janë goditur veçanërisht rëndë nga faktorë ciklikë dhe strukturorë. Nga ana tjetër, pas humbjes së vendeve të punës gjatë tremujorit të parë të vitit 2012, Mali i Zi ka patur rikuperimin më të madh në punësim gjatë tremujorit të dytë, megjithëse kjo vjen pjesërisht nga përgatitja për sezonin turistik, dhe të dhënat vjetore tregojnë luhatje të vazhdueshme.

Lëvizjet e pagave në rajon reflektojnë performancën e tregut të punës. Duke patur parasysh nivelin e lartë të papunësisë, pagat në EJT6 mbeten në përgjithësi të pandryshuara (Bosnje dhe Hercegovinë) ose pësuan rënie (Maqedoni dhe Mali i Zi) si rezultat i inflacionit në këto vende që ka shkaktuar një rënie edhe më të madhe të pagave reale (Figura 9 dhe Figura 10). Përjashtim bën vetëm Serbia, ku pagat nominale kanë ardhur duke u rritur (me përjashtim të rënies tipike në Janar pas rritjes në Dhjetor të shkaktuar nga paga e 13-të).

Figura 9: Ndryshimet në Pagat Nominale Mesatare Bruto (Janar 2011 = 100)



Burimi: Zyrat Kombëtare të Statistikave

Problemet e punësimit në rajon përbëjnë në të njëjtën kohë dhe një sfidë për përfshirjen sociale:


Pjesëmarrja e ulët e fuqisë punëtore

fsheh pabarazi të mëdha në dëm të grave, të rinjve, personave me arsim të pakët, dhe pakicave etnike. Pjesa e grave të punësuar ose që kërkojnë punë në mënyrë aktive është relativisht e ulët në EJT6, e cila mund të interpretohet si papunësi e fshehur. Për shembull, punësimi i femrave në Kosovë është vetëm 9.2 për qind, më pak se një e katërta e punësimit të meshkujve. Rezultatet e tregut të punës ndryshojnë shumë dhe ndërmjet grupeve etnike, për shembull, në Maqedoni, Romët kanë më shumë gjasa të jenë të papunë krahasuar me individë nga grupet e tjera etnike, si dhe norma e pjesëmarrjes së grave Shqiptare në fuqinë punëtore është pothuajse e papërfillshme krahasuar me atë të etnive të tjera.

Sfida e krijimit të vendeve të punës kërkon që qeveritë të shkojnë përtej reformave të institucioneve të tregut të punës dhe politikave aktive të tregut të punës. Siç trajtohet edhe në raportin e Bankës Botërore “*Vendet e Punës në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore*” dhe “*Raporti i Zhvillimeve Botërore 2013 për Vendet e Punës*”, tregu i dobët i punës dhe nivelet e ulëta të përfshirjes sociale janë rrjedhojë e faktorëve të shumtë të ndërlidhur si struktura e kërkesës për fuqi punëtore, mospërputhja e aftësive, pengesat në lëvizshmërinë e fuqisë punëtore, efektiviteti i kufizuar i mekanizmave ndërmjetësues të tregut të punës, fokusimi i dobët i arsimit të lartë. Kriza ekonomike me të cilën po përballen shumica e vendeve vazhdon të rëndojë problemet strukturore që ekzistojnë më parë, me rënien e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore dhe me rritjen e papunësisë dhe varfërisë. Për më tepër, me plakjen e popullsisë në shumicën e vendeve të rajonit, numri i pensionistëve në krahasim me popullsinë në moshë pune po rritet me shpejtësi, duke shtuar presionin mbi tregjet e punës dhe ndaj gjithë modelit shoqëror. Në mungesë të politikave imediate, situata ka gjasa të përkeqësohet. Zgjidhja e këtyre problemeve mund të çojë në rritjen e standarteve të jetesës, produktivitetit, dhe kohezionit social, me ndërmarrjen e një sërë masash për nxitjen

e rritjes ekonomike, konkurrencës, dhe krijimin e vendeve të punës, (Kutia 3). Siç shpjegon edhe *Raporti i Zhvillimeve Botërore 2013*, një numër më i lartë vendesh pune produktive dhe të mirë-paguara, mund të përmirësojë standartet e jetesës përmes sigurimit të të ardhurave, nxjerrjes të njerëzve nga varfëria dhe rritja e konsumin e tyre; si dhe të rritja e produktivitetit. Ato mund të forcojnë dhe kohezionin social në rastet kur mundësitë ekonomike ju jepen të gjitha grupeve socio-ekonomike dhe demografike.

Figura 10: Indeksi i Punësimit dhe Pagave Reale (Dhjetor 2010 = 100)



Burimi: Zyrat Kombëtare të Statistikave dhe vlerësimet e stafit të Bankës Botërore

A duhen fajësuar rregulloret e punës për performancën e dobët të tregjeve të punës në EJL6?
Përgjigja është: pjesërisht, po. Në vendet ku shumica e vendeve të punës janë krijuar nga sektori privat, rregulloret e punës mund të lehtësojnë ose të pengojnë krijimin e vendeve të punës dhe të ardhurat nga pagat. Tregjet e punës duhet të rregullohen me qëllim që të mbrojnë punëtorët nga trajtimi i padrejtë dhe të sigurojnë një marrëdhënie kontraktuale eficiente midis punëdhënësve dhe punëmarrësve. Megjithatë, rregullat e shumta mund të shkojnë përtej trajtimit të shtrembërimeve të tregut dhe të pengojnë krijimin e vendeve të reja të punës. Ku qëndrojnë vendet e EJL6 në spektrin rregullator? Për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje mund të përdoren dy tregues global: treguesi “rekrutimi i punëtorëve” i të Bërit Biznes⁵ të Bankës Botërore dhe treguesi i “efikasitetit në punë” i Forumit Ekonomik Botëror (WEF). Treguesi i të Bërit Biznes bazohet në indekse që matin fleksibilitetin në rregullat e rekrutimit, orarit të punës dhe


⁵ www.doingbusiness.org.

largimit nga puna. Këto tre aspekte të rregulloreve të punës maten me 21 tregues (Figura 12: përmban 12 treguesit që kanë divergjencën më të madhe në EJL6).

Kutia 3: Raporti i Zhvillimeve Botërore mbi Vendet e Punës: Implikimet për Politikën në Tregun e Punës

Me fokus tek vendet e punës pas krizës ekonomike globale, *Raporti i Zhvillimeve Botërore për vitin 2013* i Bankës Botërore (WDR 2013) sugjeron një qasje gjithëpërfshirëse për politikën publike jo thjesht për krijimin e vendeve të punës por për krijimin e atyre vendeve të punës që janë të mira për zhvillimin. Këto janë ato vende pune që rrisin standartet e jetesës, produktivitetin, dhe nxisin kohezionin social. Raporti WDR 2013 propozon një qasje me tre nivele në krijimin e vendeve të reja të punës që ndihmojnë zhvillimin:

Së pari, politikën bazë – përfshirë stabilitetin makroekonomik, një mjedis të përshtatshëm për biznesin, investimet në kapitalin njerëzor, si dhe sundimin e ligjit – janë thelbësore për rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Së dyti, hartimi i politikave të duhura të punës mund të ndihmojë që rritja ekonomike të përkthehet në mundësi punësimi, por ato duhet të mbështeten me një qasje më të gjerë në krijimin e vendeve të punës që shoh përtej tregut të punës. Së treti, qeveritë duhet të identifikojnë në mënyrë strategjike se cilat janë ato vende pune që i shërbejnë zhvillimit duke pasur parasysh kontekstin specifik të vendit të tyre, si dhe të heqin apo zvogëlojnë pengesat që e pengojnë sektorin privat për të krijuar më shumë vende të tilla pune.




Në këtë mënyrë, raporti WDR 2013 e zhvendos diskutimin e krijimit të vendeve të reja të punës përtej politikave të tregut të punës. Ai konstaton se politikën e tregut të punës rrallëherë mund të pengojnë krijimin e vendeve të punës të mira për zhvillim, përveç rasteve kur ato janë të tepruara apo minimale. Politikën e tregut të punës, përfshirë rregulloret e punës, marrëveshjet kolektive, programet aktive të tregut të punës dhe mbrojtjen sociale mund të frenojnë punësimin formal dhe produktivitetin në rastet kur ato janë të tepruara, ose në rastet kur rregullorja është e pamjaftueshme, mund të lejojë forma të dëmshme të punës. Nëse politikën e tregut të punës mbahen brenda kufijve të pranueshëm, efektet e tyre mund të ndjehen më shumë tek rishpërndarja se punësimi. Për shembull, legjislacioni mbi mbrojtjen e punësimit ka ndikim modest në nivelin e punësimit agregat, por kjo favorizon më tepër meshkujt në moshë aktive se sa të rinjtë, gratë apo personat me kualifikim të ulët. Nga ana tjetër, programet aktive të tregut të punës dhe politikën e mbrojtjes sociale promovojnë një nivel më të lartë punësimi dhe barazinë e pagave.

Rregullimi i tregjeve të punës në EJL6 ndryshon ndjeshëm nga vendi në vend për çdo fushë të rregullimit, por ekziston mundësia për t'i bërë tregjet e punës më fleksibël. Në drejtim të fleksibilitetit të rekrutimit, Shqipëria dhe Serbia ndalojnë përdorimin e kontratave me afat-fiks për punë të përhershme, ndërsa katër vendet e tjera kanë përcaktuar kohëzgjatjen maksimale për kontratat fikse. **Paga minimale** për punëtorët ose praktikantët është dy herë më e lartë në Bosnje dhe Hercegovinë se në Kosovë – me vendet e tjera diku në mes. Shqipëria dhe Maqedonia parashikon shpërblime më të larta për punën gjatë ditëve të pushimit dhe turneve të natës. Në Shqipëri, vendi me lehtësinë më të madhe për largimin nga puna, punëdhënësit duhet të paguajnë koston më të lartë për të larguarit. Nga ana tjetër, Serbia parashikon kosto më të ulëta të largimit nga puna por kërkon që punëdhënësit të ri-trajtojnë, ricaktojnë dhe ri-punësojnë punëtorët. Përsa i përket fleksibilitetit në rekrutim, ekziston një shumëllojshmëri qasjesh në të gjithë rajonin e EJL6 dhe në Evropë (Figura 11). Një pagë minimale e lartë

mund të dekurajojë punëdhënësit në rekrutimin e punëtorëve të rinj, dhe në këtë aspekt, Bosnje dhe Hercegovinë përbën një përjashtim negativ. Shqipëria dhe Serbia ndalojnë përdorimin e kontratave fikse për punë të përhershme, por kjo është gjithashtu një praktikë e ndjekur në disa vende të BE-11. Katër shtete të EJT6 kanë përcaktuar kohëzgjatjen maksimale për kontratat fikse, e cila në Serbi, Mal të Zi dhe Bosnje dhe Hercegovinë është më e shkurtër sesa në vendet krahasuese të BE-11. Në përgjithësi, Kosova ka rregulloret më fleksibël për rekrutimin e punëtorëve, por ajo gjithashtu ka shkallën më të lartë të papunësisë në Evropë. Së fundi, rregulloret ndryshojnë gjithashtu në drejtim të vështirësisë dhe kostos së largimit të punëtorëve (Figura 13). Me gjithë hapësirat për të përmirësuar më tej fleksibilitetin e tregut të punës në EJT6, problemi i papunësisë mbetet kryesisht strukturor dhe kërkon para së gjithash kthimin në një rritje të fuqishme ekonomike si dhe reforma të tjera strukturore (p.sh. klima e investimeve).

Figura 11: Vështirësia në Rekrutimin e Punëtorëve në EJT6




Burimi: Raporti i Të Bërit Biznes 2013

Shënim: Madhësia e rrethit paraqet pagën minimale të një punëtori 19 vjeçar. Vendet me ngjyrë blu lejojnë përdorimin e kontratave fikse për punë të përhershme.

*Shqipëria dhe Kosova nuk kanë kufij lidhur me kohëzgjatjen maksimale të kontratave fikse.


Rregulloret e tregut të punës vlerësohen dhe nga Treguesi i Konkurrencës Globale i Forumit Ekonomik Botëror (WEF). Treguesi i eficiencës së fuqisë punëtore, një nga 11 nën-treguesit, vlerëson efikasitetin dhe fleksibilitetin e tregut të punës. Ajo përbëhet nga katër fusha, tre që mbledhin perceptimet dhe një mbi kostot e pushimit nga puna që vjen nga legjislacioni i punës. Vendet e EJT6 (me përjashtim të Kosovës, e cila nuk përfshihet) renditen relativisht ulët në lidhje me efikasitetin rregullator (Figura 14). Shqipëria në vendin e 68-të nga 144 vende renditet më lart nga të gjitha, katër vendet e tjera renditen ndërmjet vendit të 93-të dhe 100. Midis vendeve fqinje, Bullgaria renditet e 45-ta, edhe pse Kroacia është në vendin e 106 dhe Rumania në vendin e 124. Me përjashtim të Shqipërisë, katër vendet e tjera të EJT6 kanë më pak pikë në drejtim të bashkëpunimit në marrëdhëniet punëdhënës-punëtor, e ndjekur nga praktikat e rekrutimit dhe pushimit nga puna. Edhe në kostot e pushimit nga puna kanë ndryshim të madh – nga 8 javë pagë në Serbi në 28 javë në Mal të Zi.

Figura 12: Shpërblimet për Turnin e Natës dhe Punën gjatë Ditëve të Pushimit në EJL6




Burimi: Të Bërit Biznes i Bankës Botërore 2013

Figura 13: Kostot e Pushimit nga Puna dhe Kërkesat për Lajmërim



Burimi: Të Bërit Biznes i Bankës Botërore 2013

Figura 14: Treguesi i Eficiencës së Fuqisë Punëtore të FEB (WEF), 2012-2013



Burimi: Forumi Ekonomik Botëror

Në mënyrë të përmblëdhur, duke pasur parasysh nivelet e larta të papunësisë, vendet e EJL6 kanë ende shumë për të bërë në drejtim të përmirësimit të institucioneve dhe rregulloreve të tregut të punës. Por është e vërtetë që faktorë jashtë tregut të punës, si rritja e ngadaltë ekonomike, investimet dhe konsumi i ulët, mangësitë në klimën e investimeve, si dhe pengesat ekonomike janë duke kontribuar në rezultatet mjaft të këqija të tregut të punës në vendet e EJL6. Krijimi i vendeve të reja të punës kushtëzohet nga faktorë të shumtë, ku më kryesori mbetet rregullorja e punës. Vendet e EJL6 vuajnë nga nivele të ulëta punësimi pjesërisht për shkak të trashëgimisë së transformimit ekonomik në vitet 1990, kur një pjesë e konsiderueshme e kapitalit u konsiderua e vjetruar. Rregulloret e punës për promovimin e krijimit të vendeve të punës mund të zbusin në një farë mase kërkesën e ulët për punëtorë. Analiza e mësipërme tregon se me gjithë ngjashmëritë me vendet e BE-11, EJL6 kanë mundësi të mjaftueshme për

të nxitur krijimin e vendeve të reja të punës duke thjeshtuar rregulloret e punës. Fushat e reformave ndryshojnë sipas vendeve, por ka gjasa që rezultatet të varen nga faktorë të tillë si fuqia dhe struktura e rritjes ekonomike dhe cilësia në klimën e investimeve, veçanërisht për bizneset e vogla dhe të mesme që janë inkubatorët e krijimit të vendeve të punës.


D. BORXHI TREGTAR DHE I JASHTËM- NË PËRKEQËSIM

Vendet e EJT6 ekonomikisht janë ngushtësisht të lidhura me BE, kështu që ajo që ndodh në sektorin e jashtëm të EJT6 është shumë e lidhur me atë që po ndodh në BE. Lidhja ishte e qartë në përkeqësimin në gjysmën e parë të vitit 2012 të tregtisë, defiçiteve të llogarive rrjedhëse (CAD), IHD, dhe transfertave në të gjithë EJT6. Përjashtim në këtë kohë ishte Shqipëria, tregtia dhe zhvillimet e jashtme të së cilës kanë tejkaluar ato të pjesës tjetër të rajonit.

Eksportet dhe Importet

Integrimi progresiv i ekonomive të EJT6 në BE do të thotë se tregtia me BE është esenciale për performancën e eksportit të vendeve të EJT6 dhe rritjen e tyre ekonomike. Edhe në kushtet e kërkesës së reduktuar, BE ende përbën rreth 58 për qind të të gjitha eksporteve të EJT6 në gjysmën e parë të vitit 2012 (pak më e ulët nga 58.8 për qind në vitin 2011). Pjesa më e madhe e eksporteve, 27.6 për qind (më e ulët nga 28.7 për qind në vitin 2011), shkon në Itali dhe Gjermani (Figura 15).


Figura 15: Eksportet (% e PBB)



Burimi: Bankat qendrore të EJT6 dhe UNCTAD


Tregtia midis vendeve të rajonit vazhdon të jetë shumë e rëndësishme në vendet e EJT6. Kjo është veçanërisht e vërtetë për Maqedoninë, B&H, Serbinë, Malin e Zi dhe Kosovën, ndërsa një pjesë e madhe e eksporteve të Shqipërisë janë të drejtuara drejt Italisë dhe vendeve të tjera të BE. Pjesa e eksporteve rajonale në PBB u rrit nga 28.3 për qind në 2011 në 30.6 për qind në vitin 2012, kryesisht për shkak se u zvogëluar eksportet drejt vendeve të tjera. Shqipëria pati rritjen më të madhe reale të eksporteve drejt vendeve të EJT6 në 2012, e ndjekur nga Kosova dhe Mali i Zi. Zhvendosja e eksporteve drejt këtyre vendeve u ndikua edhe nga një rënie e madhe në eksportet e tyre drejt vendeve të BE, me rënien e çmimeve të metaleve (Figura 16 dhe Figura 17).

Figura 16: Rritja e Eksporteve drejt EJT6 (% e PBB)



Burimi: Bankat qendrore të EJT6 dhe Eurostat


Figura 17: Rritja e Eksportit, EJT6 dhe BE (% e PBB)



Burimi: Bankat qendrore të EJT6 dhe Eurostat

Rritja e eksporteve të EJT6 u ngadalësua në gjysmën e dytë të vitit 2011 dhe gjysmën e parë të vitit 2012 për shkak të kërkesës së dobët në Eurozonë si dhe për shkak të motit të keq. Në vitin 2011 eksportet e EJT6 u rritën me 14.0 për qind, krahasuar me 14.4 për qind për BE10, por ata filluan të zvogëlohen drejt fundit të vitit. Përveç dimrit jashtëzakonisht të ashpër, shkaku kryesor i eksporteve në rënie në të gjithë rajonin është klima negative ekonomike në BE, e cila është duke rezultuar në kërkesë më të vogël për importet dhe veçanërisht në çmimet më të ulëta të metaleve. Si rezultat, rënia mesatare e ponderuar në gjysmën e parë të vitit 2012 ishte e konsiderueshme me -2,7 për qind. Eksportet në disa vende të EJT6 ranë më shumë se në vende të tjera për shkak të zvogëlimit të kërkesës së BE (Figura 18 dhe Figura 19).


Figura 18: Eksportet dhe Rritja Ekonomike (%)



Burimi: Bankat qendrore të EJT6 dhe Eurostat

Shënim: Rritja e eksportve jepet me kolona, rritja reale e PBB jepet me vija


Figura 19: Rritja e Importit (%)



Burimi: Bankat qendrore të EJT6 dhe Eurostat

Dinamika e importeve të EJT6 reflekton dobësimin e kërkesës së brendshme dhe të aktivitetit të ekonomik. Importet u forcuan në vitin 2011 në të gjithë rajonin, duke u rritur me 13,8 për qind në sajë kërkesës së brendshme dhe IHD. Megjithatë, në gjysmën e parë të vitit 2012 importet u rritën pak me rreth 1.6 për qind në terma vjetore, ndërsa kërkesa e brendshme u dobësua dhe prodhimi industrial ra (Figura 20). Për shembull, vlera e importeve në Shqipëri ra me -1,8 për qind në gjysmën e parë të vitit 2012, kryesisht për shkak të kërkesës më të ulët të brendshme për ushqime dhe për lëndë të para dhe të rënies së importeve të energjisë në tremujorin e dytë pasi u përmirësuan kushtet e motit.

Figura 20: Rritja e Eksportit dhe Importit (% vit më vit)




Burimi: Bankat qendrore të EJT6

Shënim: Të dhënat për vitin 2012 i referohen gjashtëmujorit të parë 2012

Deficitet e Llogarive Korrente dhe Bilancet Tregtare


Edhe pse deficitet e llogarisë korrente (CAD) dhe bilancet tregtare u përmirësuan ndjeshëm pas krizës, të dyja janë përkeqësuar në të gjithë rajonin. Rënia filloi në vitin 2011 (Figura 21), ku më e dukshme ishte në Kosovë, ku llogaria korrente dhe bilanci tregtar ndikohen shumë nga ndërtimi i autostradës drejt Shqipërisë dhe importet mbështetëse. Në gjysmën e parë të vitit 2012 problemi u përkeqësua me shpejtësi në Serbi, B&H dhe në Malin e Zi, kryesisht për shkak se deficitet tregtare u rritën me rënien e eksporteve dhe me rritjen e moderuar të importeve. Prirja negative e llogarive korrente dhe bilanceve tregtare është rezultat i rënies së kërkesës së BE për mallrat e EJT6. Ndikimi tjetër negativ në bilancin e llogarisë rrjedhëse erdhi për shkak të një rënie të transfertave neto në Serbi (Figura 22).

Figura 21: CAD dhe Bilanci i Tregtisë (% e PBB)



Burimi: Bankat qendrore dhe IMF ËEO dhe përlogaritjet e stafit të BB

Figura 22: CAD sipas Vendeve (% e PBB)




Burimi: Bankat qendrore të EJM6

Remitancat dhe IHD

Megjithëse remitancat kanë rënë disi në dy vitet e fundit, ato mbetën relativisht rezistente ndaj krizës së Eurozonës. Remitancat e Serbisë ranë ndjeshëm nga 9.5 për qind në vitin 2009 në 6.8 për qind në vitin 2011 dhe pastaj në 5.8 për qind në vitin 2012, ndërsa ato të vendeve të tjera ishin relativisht të pandryshuara në vitin 2012 (Figura 23). Ndryshe nga pritjet, remitancat në Shqipëri nuk kanë rënë edhe pse shumica e emigrantëve të saj kanë shkuar në Greqi dhe Itali (ndoshta për arsye kulturore dhe demografike). Për vendet e tjera të EJM6, rënia e dërgesave të emigrantëve duket se është zbutur, sepse emigrantët e tyre janë duke punuar në vende me performancë më të mirë si Gjermania, Zvicra dhe Suedia,. Gjithashtu kanë kontribuar dhe hyrja e kursimeve me kthimin e emigrantëve (Shqipëria), si dhe për shkak se politikat e punës në shumë vende të BE mbrojnë emigrantët e mirë-stabilizuar nga vendet e EJM6


Figura 23: Remitancat e Punëtorëve 2008-2011 (% e PBB)



Burimi: Bankat qendrore të EJM6.

ALB dhe BiH i përkufizojnë remitancat si shpërblim përfshirës i punonjësve; KOS, SRB, MKD dhe MNE përdorin përkufizim të ngushtë të remitancave


Figura 24: Investimet e Huaja Direkte (neto, % e PBB)



Burimi: Bankat qendrore të EJM6.

IHD - e cila është e rëndësishme për financimin, investimet dhe rritjen ekonomike të EJL6 - shënuan një rritje të fortë prej 20 përqind në 2011, por që nga ajo kohë ka rënë ndjeshëm (Figura 24 dhe Figura 25). IHD u rritën më shumë se dyfish në Serbi dhe Maqedoni në vitin 2011; pjesët e këmbimit të makinave në sektorin e industrisë, sektorët financiarë dhe të bujqësisë (Maqedoni) ishin sektorët më të suksesshëm. Por në gjysmën e parë të vitit 2012 IHD u rritën në masë të vogël në Maqedoni, Kosovë dhe B&H dhe madje pati edhe rënie të tyre në Mal të Zi dhe Serbi, kryesisht për shkak të ndikimit negativ të krizës në BE, nivelit të lartë të tyre në Serbi dhe Maqedoni në 2011, dhe flukseve të mëdha dalëse nga Serbia. Por Shqipëria mori 30 përqind më shumë IHD, të përqendruara në ndërmjetësimin financiar, shërbime dhe industri; dhe privatizimi i katër hidrocentraleve të vegjël mund të rezultojnë në të ardhura shtesë.

Figura 25: IHD për Frymë (neto, USD)




Burimi: Bankat qendrore të EKL6.

Borxhi i jashtëm

Me tkurrjen e shpejtë të kreditimit të sektorit privat, borxhi total i jashtëm i EKL6 ra në vitin 2012, por borxhi i jashtëm publik vazhdoi tendencën rritëse si rezultat i huamarrjes së jashtme të qeverive në kontekstin e rimëkëmbjes së dobët dhe të ardhurave të ulëta qeveritare. Pas arritjes së kulmit me 64.1 përqind të PBB në vitin 2010, borxhi i jashtëm ra në 60,7 përqind në vitin 2011. Që prej muajit Qershor 2009 deri në Shtator 2012, katër vende dalë në tregjet ndërkombëtare duke emetuar Eurobonde (Maqedonia në 2009, Shqipëria në 2010, Mali i Zi në 2010 dhe 2011, dhe Serbia në 2011 dhe 2012) (Figura 26) ose duke marrë kredi të huaja nëpërmjet garancive të IBRD (Serbia, Maqedonia, Mali i Zi) (Figura 27). Borxhi i jashtëm i përgjithshëm ndryshon shumë midis vendeve të EKL6, me Malin e Zi dhe Serbinë, që jo vetëm kanë nivelin më të lartë të tij por edhe shumë më të madh se mesatarja e rajonit, dhe Kosova⁶ që ka më të ulët (Figura 28).


⁶ Në dallim nga vendet e tjera të EKL6, Kosova ka akses shumë të kufizuar në tregjet ndërkombëtare financiare dhe si pasojë ka pak borxh të jashtëm.

Figura 26: Borxhi i Jashtëm i EJT6 (mesatar, % e PBB)




Burimi: Bankat qendrore dhe Ministritë e Financave (MF) të EJT6

Figura 27: Obligacione Totale Ndërkombëtare që Mbeten të Papaguara, Vende të Zgjedhura të EJT6 (milion USD)



Burimi: MF të vendeve të EJT6

Figura 28: Borxhi i Jashtëm Total Publik dhe Privat deri në Qeshor 2012 (% e PBB)



Burimi: Bankat qendrore dhe MF të vendeve të EJT6, FMN, BB

E. POLITIKA FISKALE—DEFICITE, BORXHE, DHE PAGESA TË PRAPAMBETURA NË RRIJJE

Pas përmirësimit të gjendjes në vitin 2010 dhe 2011, situata fiskale në vendet e EJT6 u dobësua në mënyrë të konsiderueshme në gjysmën e parë të vitit 2012, pasi recesioni i dytë ndikoi në buxhetet qeveritare. Deficiti fiskal mesatar i vendeve të EJT6 u përmirësua nga -3,9 për qind e PBB në 2010 në -3,1 për qind në vitin 2011, pjesërisht për shkak se rritja ekonomike filloi të rimëkëmbej. Duke pritur që kjo prirje të vazhdonte në vitin 2012, qeveritë vepruan bazuar në supozime disi optimiste të të ardhurave. Megjithatë, rritja u ngadalësua në të gjithë rajonin në gjysmën e dytë të vitit 2011 dhe u bë negative në gjysmën e parë të vitit 2012 në mes të trazirave të vazhdueshme në Eurozonë, të shoqëruara nga një dimër i ashpër që ka zvogëluar ndjeshëm aktivitetin ekonomik. Me rritjen e ngadalshme dhe buxhetimin optimist, të ardhurat nuk u realizuan në një masë të konsiderueshme; deficitet po rriten përsëri në shumicën e vendeve (Tabela 4).

Duke përdorur tashmë një pjesë të konsiderueshme të financimit të tyre të vitit 2012, shumë qeveri do ta kenë të vështirë të përmbushin objektivat e rishikuara të tyre të deficitit për vitin 2012. Për shembull, si Serbia dhe Maqedonia kishin përdorur deri në Gusht rreth 75 për qind të të ardhurave të planifikuara për vitin 2012. Prandaj, deficitet ka të ngjarë të jenë më të larta se sa pritej.


Tabela 4: Bilancet Fiskale të EJT6 2008-12 (% e PBB)

	2008	2009	2010	2011	2012 Proj. ¹
ALB	-5.5	-7.0	-3.0	-3.3	-3.6
BIH	-3.9	-5.7	-4.5	-3.1	-3.5
KOS	-0.2	-0.6	-2.6	-1.9	-2.7
MKD	-0.9	-2.7	-2.4	-2.6	-3.7
MNE	-1.3	-5.3	-4.7	-4.3	-3.6
SRB	-2.6	-4.7	-5.0	-5.0	-6.7

¹Të dhënat më të fundit të disponueshme: Gusht për Maqedoninë, Malin e Zi, dhe Serbinë; Korrik për Shqipërinë dhe Kosovën.


Megjithëse vendet e EJT6 kanë zbatuar politika fiskale kundërciklike për gjatë një periudhe më të gjatë, suficitet ishin shumë të vogla për të krijuar hapësirë manovrimi gjatë një krize të zgjatur. Pas vitit 2000, balanca fiskale strukturore përgjithësisht ka lëvizur në përputhje me rritjen ekonomike (Figura 29 dhe Figura 30). Gjatë periudhës së rritjes më të madhe (2005-07), vendet e EJT6 mesatarisht kishin suficite (megjithëse në retrospektivë ato nuk ishin asnjëherë të mëdha sa duhej - sidomos në Mal të Zi, i cili përjetoi edhe bumin më të madh por edhe dështimin më të keq) dhe më pas, në 2008, kaluan në deficite për shkak të goditjeve të efekteve të krizës ekonomike. Problemi ishte se vendet në rajon nuk krijuan burime të mjaftueshme gjatë bumit ekonomik për të të financuar deficitet e zgjatura gjatë krizës. Në të vërtetë, pavarësisht nga rritja mesatare prej rreth 3.8 për qind në vitet 2000, ato kishin deficite strukturore mesatarisht mbi 1 për qind të PBB. Disa politika fiskale kundërciklike ishin më të suksesshme se të tjerat. Kosova, Mali i Zi, dhe në një masë më të vogël Bosnja kishin teprica fiskale në bazë strukturore gjatë zgjerimit. Megjithatë, pavarësisht rritjes së fortë ekonomike Shqipëria dhe Serbia kishin deficite (Figura 30).

Figura 29: Rritja Ekonomike dhe Deficiti Struktural (jo i ponderuar, përqindje e PBB)



Burimi: Përlogaritjet e stafit të Bankës Botërore

Figura 30: Deficitet Strukturore, 2005-11



Shënim: Bilanci struktural i referohet bilancit të përgjithshëm të qeverisë ciklikisht të rregulluar, i cili është bilanci fiskal i rregulluar për efektet e ciklit ekonomik duke përdorur filtrin Hodrick-Prescott (HP). Për një diskutim mund të shihni Giorno etj. (1995), i disponueshëm në <http://78.41.128.130/dataoecd/2/43/33928808.pdf>.

Me tregtinë dhe kërkesën e brendshme në nivele të ulëta, përqindja e të ardhurave fiskale ndaj PBB u zvogëlua në shumicën e vendeve të EJT6 në gjysmën e parë të vitit 2012 në krahasim me vitin 2011. Deri më tani në vitin 2012, të ardhurat janë më të ulëta se sa në njëjtën periudhë e vitit të kaluar me një mesatare prej 0.6 për qind të PBB-së në Shqipëri, Maqedoni, dhe Serbi (Figura 31). Aktiviteti i ngadalësuar ekonomik ka goditur rëndë veçanërisht disa burime të të ardhurave: në Shqipëri dhe Maqedoni, mbledhja e tatimit mbi fitimin është reduktuar; dhe në këtë të fundit dhe në Kosovë, të ardhurat nga TVSH janë zvogëluar. Për shkak të problemeve në tregun e punës, të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale janë reduktuar në Shqipëri, Maqedoni, dhe Serbi. Përveç të ardhurave të ulëta aktuale në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, vendet e EJT6 kanë të ardhura më të ulëta se ato të parashikuara në buxhet.

Shpenzimet në disa vende janë rritur, për arsye të ndryshme (Figura 32). Në disa vende të EJT6 shpenzimet korrente janë rritur në shtatë muajt e parë të vitit 2012, të udhëhequra nga përfitimet e sigurimeve shoqërore. Në Shqipëri kjo është përkeqësuar nga rritja pensione dhe pagave publike më shumë se norma e inflacionit. Në Shqipëri dhe Maqedoni, ulja në shpenzime kapitale kanë kompenzuar pjesërisht ose plotësisht rritjen e shpenzimeve korrente, por në Serbi, një rritje prej gati 10 për qind e shpenzimeve totale është duke ushtruar presion mbi qëndrueshmërinë fiskale. Në Kosovë, rritja e shpenzimeve prej rreth 14.8 për qind është pjesërisht rezultat i një buxheti të vonuar në vitin 2011. Megjithatë, ndryshe nga vendet e tjera të EJT6, shpenzimet kapitale të Kosovës u rritën me gati 25 për qind, kryesisht për projekte të transportit për lidhje më të mirë me vendet fqinje.

Figura 31: Të ardhurat Reale të EJL6, 2008-12





Figura 32: Shpenzimet Reale të EJL6, 2008-12



Shumica e vendeve të EJL6, edhe pse me kohë të ndryshme, kanë njohur nevojën për të zgjidhur problemet fiskale në mënyrë të drejtpërdrejtë me përpjekjet për të rritur të ardhurat dhe zvogëluar shpenzimet. Disa vende të EJL6 kanë ngritur akcizat (Mali i Zi) dhe TVSH dhe tatimi mbi fitimin (Serbia) dhe kanë lëvizur drejt shkurtimit të shpenzimeve (Maqedonia, Mali i Zi). Por disa vendë të tjera, duke u përballur me mbledhjen e ngadaltë të të ardhurave e kombinuar kjo me mundësitë e kufizuara të financimit (BiH dhe Kosovë) kërkuar financime nga institucionet ndërkombëtare financiare (IFI). Ndërsa vendet e tjera të EJL6 janë përpjekur për të kontrolluar shpenzimet, pavarësisht rritjes në pensionet dhe pagat mbi nivelin e inflacionit, Shqipëria ka zgjedhur të presë për të parë nëse materializohen privatizimet e planifikuara, një qasje që tregjet mund ta penalizojnë përmes interesave më të larta, nëse të ardhurat e pritura janë më të ulëta se ato të parashikuara.

Kutia 4: Rimbursimi i taksave dhe Shpenzimet e Papaguara: Shqetësim në Rritje

Për shkak të aktivitetit të dobët dhe buxheteve nën presion, shumica e vendeve në rajon kanë pësuar rritje të pagesave të prapambetura për rimbursimet e taksave dhe pagesave të prapambetura qeveritare që nga viti 2008. Pagesat e prapambetura krijohen kur pagesat nuk kryhen brenda një periudhe të arsyeshme pas mbarimit të afatit të tyre. Megjithatë, përkufizimi i pagesave të prapambetura mund të ndryshojë në varësi të vendit dhe llojit të faturës. Për shembull, në Mal të Zi, rimbursimet e TVSH konsiderohen pagesa të prapambetura 60 ditë pas dorëzimit të kërkesës për rimbursim, por për pagat konsiderohet pagesë e prapambetur nëse ato nuk paguhet në kohë. Në Kosovë, çdo faturë për mallra dhe shërbime e cila nuk paguhet brenda 30 ditësh nga hyrja në sistemin e thesarit konsiderohet pagesë e prapambetur. Stoku i pagesave të prapambetura është i vështirë për t'u matur me saktësi, por në Ballkanin Perëndimor ai vlerësohet mesatarisht 1–3.5 për qind e PBB të kombinuar.

Shkaqet për krijimin e pagesave të prapambetura janë komplekse dhe ndryshojnë sipas vendeve, por ndikimi i tyre mund të jetë i dëmshëm në disiplinën financiare, likuiditetet dhe veprimtarinë ekonomike. Një nga arsyt kryesore për pagesat e prapambetura kanë qenë parashikimet tepër optimiste të të ardhurave që çuan në shpenzime të cilat nuk mund të mbulohen nga të ardhurat e mbledhura. Kjo është përkeqësuar nga pasiguria rreth kushteve ekonomike dhe të tregtisë në Evropë. Për rrjedhojë, të ardhurat e pakta dhe fluksi i shtrënguar i parasë i kanë shtyrë qeveritë të zgjasin periudhat e pagimit dhe të vonojnë pagesat, gjë e cila natyrisht vë në lëvizje një reaksion zinxhir të mospagimit nga ana e


furnizuesve privatë e për rrjedhojë një shterim të likuiditetit në një ekonomi tashmë në vështirësi. Në disa raste bizneset janë inkurajuar që të shtyjnë paraqitjen e faturave për punën e kryer, ose qeveritë kanë lehtësuar kërkesat për regjistrimin e detyrimeve, në mënyrë që të mbulohet shtrirja e plotë e detyrimeve të pagesës. Ndikim ka patur dhe sjellja e agjentëve ekonomik: disa kompani private, të cilave u detyrohet sektori publik, janë të detyruara të shmangin taksat për të qëndruar në biznes. Në raste ekstreme, pagesat e prapambetura mund të çojnë në një kolaps total të disiplinës së pagesave, siç ndodhi, për shembull, në fillim të viteve 1990 në Ukrainë dhe në ish-Jugosllavi në prag të hiperinflacionit në 1992.

Rritja e pagesave të prapambetura mund të lehtësojë përkohësisht fluksin e parasë për qeveritë, por ndikimet janë shumë më të gjera dhe në fund pagesat duhet të kryhen. Vonesat në pagesat e qeverisë kanë efekt të drejtpërdrejtë negativ në konsum, punësim dhe investime, sepse njerëzit të cilët kanë kryer furnizimin e mallrave dhe shërbimeve nuk kanë marrë fondet që u duhen për të paguar faturat dhe për të vazhduar bizneset e tyre. Situata ekonomike e bën këtë edhe më të vështirë për shkak se bizneset nuk mund të marrin hua për të marrë paratë e nevojshme për të paguar pagat dhe furnizuesit e tyre. Faturat e papaguara gjithashtu ndikojnë në gatishmërinë dhe aftësinë e tyre për të investuar në rritjen dhe zgjerimin e biznesit. Në periudhë afatmesme, furnizuesit e qeverisë do të rrisin çmimet ose do të kërkojnë të para-paguhet nëse ata mendojnë se nuk do të paguhet brenda një kohe të arsyeshme. Disa firma do të ndërpresin ofertat për kontratat qeveritare, e cila do të reduktojë konkurrencën dhe vlerën e parasë.

Është me rëndësi jetike që qeveritë të veprojnë shpejt për adresimin e pagesave të prapambetura kur ato janë ende të menaxhueshme. Nëse rriten në mënyrë të pakontrolluar, pagesat e prapambetura mund të kërcënojnë qëndrueshmërinë fiskale dhe besueshmërinë kredimarrëse të vendit në mënyrë të pariparueshme. Bashkërendimi i veprimeve për pagesat e prapambetura kërkon menaxhim të kujdesshëm të ardhurave dhe fluksit monetar si dhe procedura të forta për kontrollin e detyrimeve të shpenzimeve dhe përpunimit të rimbursimeve tatimore: regjistrimin e saktë të faturave dhe kërkesave për rimbursim tatimor, monitorimin e sasisë dhe afateve të pagesave, dhe buxhetimin e burimeve të mjaftueshme për të paguar detyrimet brenda një periudhe të përcaktuar. Një element i rëndësishëm i planit të veprimit është të parandalimi i krijimit të pagesave të reja të prapambetura duke zbatuar një plan për eliminimin e stokut të pagesave. Disa rritje në deficit –nëse janë të financueshme –do të ishin të justifikuara nëse përfshijnë një plan kohor për eliminimin e pagesave të prapambetura. Ministria e Financave duhet të monitorojë nga afër detyrimet dhe pagesat për të garantuar që njësitë buxhetore respektojnë afatet e pagesave dhe nuk kompensojnë reduktimin e pagesave të prapambetura duke shkaktuar detyrime të reja të pakontrollueshme.

Në Serbi, Shqipëri dhe Mal të Zi, borxhi publik është shumë i lartë (Figura 33). Në Gusht, borxhi publik Serb qëndronte në 57.6 përqind, shumë më lart se tavanin prej 45 përqind i vendosur nga Ligji për Përgjegjësinë Fiskale. Shqipëria gjithashtu ka shkelur prapë prapë kufirin prej 60 përqind të PBB. Borxhi publik i Malit të Zi është rritur ndjeshëm, mbi 59 përqind të PBB, kryesisht për shkak të deficiteve të larta gjatë krizës dhe pas saj si dhe garancive shtetërore. Këto vende duhet të bëjnë përpjekje shtesë për të zbatuar konsolidimin fiskal dhe për të siguruar besimin e huadhënësve. Duket se Bosnje dhe Hercegovina, Kosova dhe Maqedonia janë brenda niveleve të qëndrueshme të borxhit publik. Borxhi i Bosnje dhe Hercegovinës ishte rreth 40 përqind e PBB në fund të vitit 2011 por duhet ulur në përdhën afatmesme duke mbajtur parasysh paqëndrueshmërinë e vendit. Borxhi publik i Kosovës është tani rreth 9 përqind e PBB, ndonëse përpjekjet për të ndërtuar një treg të brendshëm kreditimi mund ta rrisin atë pak në vitin 2013. Borxhi publik në Maqedoni është i moderuar - rreth 30 përqind e PBB.

Figura 33: Borxhi Publik dhe Garancitë Publike (% e PBB)



Në disa vende rifinancimi i borxhit – sidomos ai me probleme afat-shkurtra – do të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme në kërkesat e financimit bruto. Deri tani, vendet e EJT6 kanë qenë në gjendje të rinovojnë borxhin e tyre, por nëse ato do mund të vazhdojnë varet nga besimi i tregut. Disa vende gjithashtu kanë shuma të mëdha për të paguar në fund të 2012 dhe në fillim të 2013 për obligacionet afat-afatgjata të tyre.

Dinamikat e pafavorshme të borxhit publik kanë rezultuar në ulje të vlerësimit të borxhit sovran të dy vendeve EJT6 që nga muaji Qershor. Në kushtet e dinamikave gjithnjë e më të pafavorshme të borxhit publik, Standard and Poor (S&P) ka ulur vlerësimin e borxhit sovran të Malit të Zi dhe Serbisë (Tabela 5). Këto ulje mund të pengojnë daljen në tregje për financimin e deficitit. Vlerësimet mund të ulen më tej nëse materializohen rreziqet aktuale të qëndrueshmërisë fiskale dhe të borxhit.

Tabela 5: EJT6: Renditjet e Kredisë Sovrane¹

	Dhjetor 2010	Dhjetor 2011	Mars 2012	Qershor 2012	Shtator 2012
ALB	B+	B+	B+	B+	B+
BIH	B+	B	B	B	B
MKD	BB	BB	BB	BB	BB
MNE	BB	BB	BB	BB-	BB-
SRB	BB-	BB	BB	BB	BB-

Burimi: Standart&Poor

¹ Borxhi afatgjatë në monedhë të huaj më 19 Tetor, 2012. Kosova nuk ka vlerësim të borxhit sovran


Së fundi, nga periudha afatshkurtër deri në atë afatmesme vendet e EJT6 përballen me rreziqe të mëdha, të brendshme dhe të jashtme, që mund të dëmtojnë qëndrueshmërinë fiskale. Rreziqet e jashtme janë të lidhura me rritjen e dobët ekonomike në Evropë dhe në pasigurinë e sektorit financiar në mbarë botën. Përhapja e vazhdueshme e efekteve (nëpërmjet kërkesës për eksporte ose gërryerjes të besimit të biznesit) nga një Eurozonë me performancë të dobët ka të ngjarë se do të ushtrojë presion të mëtejshëm për rënie të të ardhurave dhe të kërkojë rregullime ekuivalente të shpenzimeve. Ankthi i

tregjeve financiare mund të bëjnë të vështirë ose të kushtueshëm sigurimin e fondet të nevojshme për të financuar deficitet e qeverive. Raporti i lartë borxhit ndaj PBB përbën më shumë rrezik për Serbinë, Shqipërinë dhe Malin e Zi, por një humbje e përgjithshme e besimit për tregjet në zhvillim (një "fluturim drejt aseteve të sigurt") mund të ndikojë të gjitha vendet e EJL6. Rreziqet e brendshme janë kryesisht politike. Ata reduktohen nëpërmjet mbajtjes nën kontroll të shpenzimeve gjatë cikleve zgjedhore në Maqedoni dhe Shqipëri.

F. SEKTORI FINANCIAR – VAZHDON TË MBETET I PREKSHËM

Vendet e Ballkanit Perëndimor janë shumë të integruara me Evropën Perëndimore nëpërmjet tregtisë, punës, dhe financave – kjo e fundit përbën transmetuesin më të shpejtë të problemeve të Eurozonës. Afërsisht gjysma e eksporteve të rajonit shkojnë në vendet e Eurozonës, dhe remitancat nga Eurozona kontribuojnë mestarisht me 10 për qind të PBB. Por zhvillimet negative në Eurozonë kanë patur efekte të vonuara në tregtinë dhe remitancat e vendeve të EJL6. Lidhjet financiare të analizuar më poshtë, ka mundësi të kenë efektet më të menjëhershme.


Figura 34: Pretendimet Ndërkombëtare (% e PBB, 2012 T2)



Burimi: BIS

Shënim: GIIPS = Greke, Italiane, Irlandeze, Portugeze dhe Spanjolle

Figura 35: Huatë në Monedhë të Huaj (% e totalit, 2012 T3)



Burimi: Bankat Qendrore

Filialet Evropiane kanë një prani të madhe në sistemet bankare të EJL6, si dhe ekziston një shkallë e lartë euroizimi.⁷ Sistemet financiare të rajonit të orientuara nga bankat dominohen përgjithësisht nga banka Evropiane, kryesisht nga Austria, Franca, Italia, Greqia dhe Sllovenia. Prania e bankave nga vende Evropiane me të ardhura të larta varion gjerësisht (Figura 34). Rritja e globalizimit ka ndihmuar në thellimin e sistemeve financiare si dhe ka pasur efekte të tjera pozitive si, kosto të ulëta në huamarrje, shërbime financiare cilësore gjithëpërfshirëse, diversifikimi i rrezikut përtej kufijve, si dhe përhapjen e

⁷ Kosova dhe Mali i Zi kanë euron në përdorim të plotë; Bosnje dhe Hercegovina dhe Maqedonia kanë monedhat të lidhura me euron; Serbia ka një rregjim me kurse këmbimi luhatëse të menaxhuara dhe Shqipëria ka një regjim me kurse këmbimi luhatëse.

efekteve teknologjike dhe institucionale. Por të gjithat këto e kanë bërë rajonin edhe më të prekshëm ndaj goditjeve të jashtme. Sistemet bankare në disa vende të EJK6 janë tepër të ekspozuara ndaj kredive në monedhë të huaj dhe për rrjedhojë mospërputhjeve të monedhave (Figura 35). Gjithashtu, vendet e rajonit kanë raporte mjaftueshmërie kapitali të krahasueshme por ka ndryshime të mëdha mes vendeve për raportet e kapitalit dhe provigjoneve (Figura 36 dhe Figura 38).


Rritja e shpejtë e kreditimit deri në vitin 2008 u ndërpre me fillimin e krizës; bankat e rajonit panë shterimin e financimeve të huaja dhe në disa raste tërheqje të depozitave⁸. Rritja vjetore e kreditimit të brendshëm ishte mesatarisht 25 për qind ndërmjet viteve 2006 dhe 2008, e nxitur nga flukset e kapitalit të huaj në sektorin financiar. Flukset u motivuan pjesërisht nga likuiditeti i bollshëm global, pjesërisht nga perspektivat ekonomike dhe stabiliteti politik i rajonit, dhe kryesisht nga perspektivat e anëtarësimit të mundshëm në BE për vendet e Ballkanit Perëndimor⁹. Me shterimin e fondeve nga jashtë, bankat u detyruan të përshtateshin. Bosnje dhe Hercegovina, Mali i Zi, dhe Serbia patën rrjedhje të depozitave. Ngërçi i kreditimit është ende e rëndë, duke reflektuar jo vetëm kërkesë më të ulët, por edhe probleme në rritje lidhur me cilësinë e aktiveve pasi disa banka mëmë filluan të tkurrin kreditimin.

Megjithëse kriza e Eurozonës u arrit të frenohet, deri më sot në vendet e Ballkanit Perëndimor, sistemet bankare të EJK6 karakterizohen ende nga një numër në rritje ose numër tashmë i lartë i kredive me probleme, rritje e ulët e kreditimit, pakësimin e kapitalit dhe norma minimale fitimi. Nivelet e larta të kredive me probleme (NPLs) nënkuptojnë se cilësia e huadhënies është përkeqësuar, dhe bankat kanë vështirësi kronike në zgjidhjen e kredive me probleme për shkak se regjimet inefficente të falimentimit nuk lejojnë zgjidhjen e shpejtë të këtyre kredive. Rritja e kredive me probleme kohët e fundit ka pakësuar nxitjen si dhe aftësinë e bankave për të rifilluar huadhënien. Për më tepër, raportet kredit-depozita të bankave janë mbi 100 për qind në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi, duke reflektuar një bazë të vogël depozitash vendase dhe varësi relativisht të lartë nga financime të mëdha (Figura 39). Në të njëjtën kohë, mbizotërimi i kredive në monedhë të huaj mund të evidentojë rreziqe të lidhura me kursin e këmbimit të huamarrësve të pambrojtur, që është një shqetësim i mprehtë në disa vende.

⁸ Si rezultat i krizës, disa vende kanë hyrë në programet e FMN. Në Korrik 2009, Bosnja dhe Hercegovina nënshkroi një Marrëveshje Financimi (SBA) për 1.1 miliardë euro që përfundoi në Korrik 2012; kanë nisur diskutimet për një program 500 milionë US\$. Në Prill 2012, Kosova nënshkroi një marrëveshje stand-by me FMN për 107 milionë euro deri në Dhjetor 2012. Në Janar 2009, Serbia nënshkroi një Marrëveshje stand-by për 2.619 miliardë SDR që përfundoi në Prill 2011. Linja Parandaluese dhe e Likuiditetit (PCL) e Maqedonisë nuk pritet të tërhiqet.


⁹ Serbia u pranua si vend kandidat në BE në Mars 2012.

Figura 36: Rritja e Kreditimit (% e ndryshimit, T/T)




Burimi: IFS

Figura 37: Kreditë me Probleme (% e Kredive Totale) dhe Provigjioni (% e Kredive me Probleme, 2012 T2)




Burimi: FMN dhe bankat qendrore

Figura 38: Koeficientët e Mjaftueshmërisë së Kapitalit dhe Kthimit mbi Aktivet (% , 2012 T2)



Burimi: FMN dhe bankat qendrore

Figura 39: Raportet Hua-Depozitë (% , 2012 T2)



Burimi: FMN dhe bankat qendrore

Kushtet e brishta makroekonomike dhe skemat relativisht modeste të sigurisë në sektorin financiar e ndërlikojnë panoramën¹⁰. Disa prej vendeve të EJT6 janë ende mbartin trashëgiminë e shpenzimeve të tepërta dhe borxh të madh publik dhe të jashtëm. Kjo mund të ketë pasoja të rënda duke pasur parasysh reagimet negative të lidhjeve borxh sovran – bankë (siç u demonstrua nga ngjarjet e fundit në Eurozonë). Megjithatë rrjetat e sigurisë financiare në rajon variojnë, fondet e sigurimit të depozitave mund të përmirësohen duke nënkuptuar mundësinë e detyrimeve të lidhura.

¹⁰ Zakonisht, rrjetat e sigurisë në sektorin financiar përbëhen nga tre elemente kryesore: mjeti për mbështetjen e likuiditetit; sigurimin e depozitave plus skemat e mbrojtjes së investitorëve dhe mbajtësve të policave; dhe politikat për menaxhimin e krizave.

Tabela 6: Treguesit Kryesorë Makroekonomik (projektimet e 2012, % e PBB) dhe Skemat e Sigurisë Financiare

	Bilance t Fiskale	Bilanci i Llogarisë Korrente	Borxhi Publ	Borxhi i Jashtëm	Karakteristika të Skemës së Sigurisë Financiare
Shqipëria	● -3.6	● -11.8	● 60.8	● 35.5	- Rezervat të mjaftueshme për ndihmë emergjente të likuiditetit - Mjete të reja në dispozicion për zgjidhjen e bankës - Mbulimi i ulët i sigurimit të depozitave - Financimi emergjent nga Ministria e Financave duke u finalizuar
BiH	● -3.5	● -9.9	● 43.9	● 52.5	Sigurimi i depozitave forcohet nga linja e kredisë së BERZH, mbulimi i rritur
Kosova	● -3.1	● -21.3	● 9.0	● 8.5	- Rregullimi i ri për ndihmë emergjente të likuiditetit - Fondet e sigurimit të depozitave janë të limituara; për tu rritur me fondet e KfW
RiJ Maqedonia	● -3.7	● -3.5	● 30.6	● 63.2	- Mbulimi i limituar i sigurimit të depozitave - Kontribute të jashtëzakonshme dhe financim i kontigjencave: të parashikuara
Mali i Zi	● -3.6	● -23.7	● 61.6	● 102	- Likuiditet emergjent i limituar - Mjete të pamjaftueshme për zgjidhjen e bankës - Pak hapësirë fiskale për financimin e sigurimit të depozitave
Serbia	● -6.7	● -11	● 65.0	● 80.0	- Niveli i lartë i rezervave për ndihmë emergjente të likuiditetit - Mjete të ndryshme për zgjidhjen e bankës - Sigurimi i depozitave është i limituar dhe mbulimi i ulët. - Financimi i kontigjencave vjen nga buxheti i shtetit

Burimi: *Perspektiva Ekonomike Botërore*, FMN; llogaritjet e stafit të Bankës Botërore bazuar në statistikat kombëtare.

Pragjet (e kuqe, e verdhë, jeshile) janë si më poshtë: bilanci fiskal (<-3, <-2, >-2), bilanci i llogarive korrente (<-10, <-3, >0), borxhi publik (>60, >30, <30), borxhi i jashtëm (>60, >40, <40).


Përveç mjedisit të brishtë të biznesit dhe rreziqeve karakteristike të vendit, ngjarjet e lidhura me Eurozonën përbëjnë ende kërcënim për të gjithë rajonin. Tërheqja e depozitave bankare dhe ngrirja e financimeve nga bankat mëmë mund të shkaktojnë probleme për bankat në pronësi të huaj. Modeli gjerësisht i adoptuar i filialeve u ofron mundësinë autoriteteve bankare të Ballkanit Perëndimor të reagojnë ndaj goditjes së mundshme me izolimin e bankave të prekura, megjithëse efektet e mundshme negative si për bankat vendase ashtu edhe për ato të huaja si rrjedhojë e tërheqjes së depozitave në vendet e Eurozonës dhe për më tepër faktorët që kufizuan efektet negative gjatë periudhës 2008-09 ka gjasa të mos jenë efikas. Niveli i euroizimit në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor zvogëlon efikasitetin e këtyre masave.

Megjithëse vendet e Ballkanit Perëndimor kanë ndërmarrë reforma të rëndësishme në sektorin financiar gjatë viteve të fundit, mbetet ende punë e madhe për tu bërë. Duke pasur parasysh hapjen e tyre financiare, nivelet e larta të kredive me probleme, rritjen e ulët të kreditimit dhe kapitalizimin në rënie, të gjitha vendet e EJT6 duhet të përqendrohen në gatishmërinë dhe menaxhimin e krizave, si dhe të punojnë për zgjidhjen e kredive me probleme dhe procedurave të falimentimit. Mbikëqyrja efikase dhe rigorozet e sektorit financiar si dhe menaxhimi i krizave kërkon, ndër të tjerash, sisteme që lejojnë ndërhyrje të hershme dhe të shpejta në bankat me probleme; aftësinë për të lehtësuar rikapitalizimin nga aksionerë privatë sipas rastit; mekanizma efektive për zgjidhjen e institucioneve të falimentuara; asistencë emergjente për likuiditete; dhe mbrojtjen e depozituesve për të mbështetur besimin në sistemin financiar. Për të rifilluar rritjen e kreditimit, nevojitet reduktimi i kredive me probleme përmes masave të tilla si heqja e barrierave ligjore, rregullatore dhe tatimore për ristrukturimin e borxhit¹¹. Në seksionet pasardhëse, do të nënvizojmë tre çështje strukturore me rëndësi për kapacitetin e rajonit për të garantuar rimëkëmbje të qëndrueshme ekonomike dhe investime të larta vendase dhe private: mjedisin e të bërit biznes, perspektivat e privatizimeve, dhe deficitin që po krijohet në infrastrukturën energjitike.

G. ÇËSHTJE STRUKTURE: MJEDISI NË EJT PËR TË BËRË BIZNES

Mjedisi i vështirë në EJT6, si ai i jashtëm ashtu dhe ai i brendshëm, sugjeron nevojën që këto kompani të përshpejtojnë reformat strukturore në mënyrë që të jenë më produktivë, konkurrues dhe tërheqës për të bërë biznes. Axhenda e papërfunduar e reformës strukturore u diskutua në botimin e Nëntorit 2011 të këtij raporti, ka shumë të ngjarë që plotësimi i axhendës është bërë më urgjent me fillimin e recesionit të dyfishtë. Ende në axhendë janë reformat e qeverisjes së sektorit publik, klimës së biznesit, tregjeve të punës dhe rrjetave të sigurisë sociale. Në atë botim, ne theksuam progresin e kohëve të fundit dhe çështjet e mbetura për sa i përket klimës të të bërit biznes dhe perspektiva për privatizimin ndërkohë që qeveritë kërkojnë të lehtësojnë kufizimet financiare dhe të tërheqin investimet e huaja në kushte të jashtme më të vështira.

Figura 40: EJT6 Lehtësia e të Bërit Biznes, 2011-13



Burimi: Banka Botërore Të Bërit Biznes 2013


¹¹ Vlen të theksohet fakti se FinSac (Qendra për Konsulencë në Sektorin Financiar, e vendosur në Vjenë) ka arritur një marrëveshje tentativë me Malin e Zi dhe Shqipërinë për të ofruar asistencë teknike gjithëpërfshirëse për reduktimin e kredive me probleme.

Raporti i fundit i Të Bërit Biznes 2013 dokumenton përmirësimet në vendet e EJJ6 në disa fusha, sic janë fillimi i një biznesi, trajtimi i lejeve të ndërtimit dhe lehtësia e pagimit të taksave. Megjithatë, ka shume dallime në renditjen e gjashtë vendeve dhe ka ende nevojë për shumë punë. Gjithashtu, renditja mesatare e vendeve të EJJ mbetet mjaft mbrapa asaj të BE11, duke theksuar axhendën e gjatë të papërfunduar (Figura 41).

- **Maqedonia** është përsëri kampioni rajonal për fillimin e një biznesi dhe renditja e saj globale (23) në shkallën e Të Bërit Biznes është e shkëlqyer. Ajo ka reduktuar koston e lidhjes me infrastrukturën e energjisë elektrike, duke rezultuar në një përmirësim në kategorinë Marrja e Energjisë. Gjithashtu është përmirësuar pak trajtimi i lejeve të ndërtimit.
- **Mali i Zi** përmirësoi aksesin në informacionin e kreditimit duke garantuar të drejtën e huamarrësve për të inspektuar të dhënat e tyre personale dhe duke bërë marrjen e një leje ndërtimi më pak të shtrenjtë. Ajo gjithashtu përmirësoi në mënyrë të rëndësishme renditjen për lehtësinë e pagimit të taksave. Rezultati është një renditje në vendin e 51-të në vitin 2013, një ngritje nga vendi 56-të në vitin 2012.
- **Shqipëria** bëri fillimin e një biznesi më të lehtë duke bërë noterizimin e dokumenteve të themelimit opsionale. Ajo e bëri pagesën e taksave të biznesit më të lehtë duke hequr taksën e automjetit dhe duke nxitur deklarin elektronik. Megjithatë, për shkak të stanjacionit në shumë kategori dhe performancës relativisht më të mirë të vendeve të tjera, renditja e Shqipërisë në të vërtetë u përkeqësua, nga vendi i 82-të në vitin 2012 në vendin e 85-të në vitin 2013.
- Rënditja e **Serbisë** përparoi në mënyrë të rëndësishme. Ajo ka thjeshtuar procesin e falimentimit duke futur një seri masash, siç janë përmbaruesit privatë, duke ulur çmimet e fillimit për shitjen e aseteve, duke ndaluar ankimimet, dhe duke përshpejtuar shërbimin e procesit. Sistemi i ri i përmbaruesve privatë gjithashtu e bëri më të lehtë zbatimin e kontratave. Serbia gjithashtu e ka bërë më të lehtë fillimin e një biznesi duke eliminuar kërkesën për minimum të kapitalit të paguar nga investitorët. Si rezultat, renditja e përgjithshme e Serbisë është përmirësuar në vendin e 86-të në vitin 2013 nga vendi i 92-të në vitin 2012.
- Rënditja e **Kosovës** përparoi kryesisht nga një bazë e ulët. Kosova forcoi mbrojtjen e investitorëve duke futur një kërkesë për miratimin nga aksionerët të transaksioneve me palët e lidhura. Ajo gjithashtu e bëri fillimin e një biznesi më të lehtë duke eliminuar kërkesën për kapital minimal dhe tarifën e regjistrimit të biznesit, duke rezultuar në përmirësim në renditje, nga vendi i 117-të në vitin 2012 në vendin e 98-të për vitin 2013.
- Rënditja e **Bosnjë Hercegovinës** ra pak, nga vendi i 125-të në vitin 2012 në vendin e 126-të në vitin 2013. Megjithatë BiH ka lehtësuar barrën administrative për deklarin dhe pagesën e sigurimeve shoqërore duke zbatuar deklarin dhe lagesën elektronike. Nëpërmjet kompjuterizimit të regjistrimit tregtar, ajo gjithashtu e ka bërë më të lehtë transferimin e pronave ndërmjet kompanive.

Vendet në rajon duhet të shkëmbejnë praktikatat më të mira në mënyrë që përmirësimet në renditje të jenë gjithëpërfshirëse dhe më të shpejta. Kjo është e rëndësishme jo vetëm për të tërhequr investitorët e huaj por edhe për të shërbyer si një referencë për reformat dhe për të nxitur rritjen.

Figura 41: Pikat e dobëta të klimës të biznesit 2012 në EJL6



■ Renditja 1-185 (më e vështira) — Mesatarja e Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore duke përfshirë Turkmenistanin

Burimi: Treguesit e të Bërit Biznes 2013

Axhenda e papërfunduar në klimën e biznesit është ilustruar nga pikat e dobëta të të bërit biznesit (Figura 41). Ato pika të dobëta, kryesisht të zakonshme në vendet e SEE6 lidhen me kuadrin rregullator të biznesit që rregullojnë transaksionet pronësore dhe banesore dhe industrinë e ndërtimit, si dhe zbatimi i kontratave. IRJ e Maqedonisë, megjithatë, ka arritur të përmirësojë shumë dimensionet e saj të klimës së biznesit. Gjithashtu, disa vende në rajon renditen relativisht mirë në aspektin e lehtësive për të paguar taksat. Por është e rëndësishme të theksohet se këta tregues kapin aspekte të caktuara rregullatore dhe ligjor në dhjetë fusha të politikës, por ka aspekte të tjera të klimës së investimeve dhe praktikave të biznesit që mund të jenë të rëndësishme për investime dhe rritjen ekonomike (p.sh., cilësia e infrastrukturës dhe pabarazia në tatimin e firmave formale ndaj atyre joformale), të cilat mund të jenë pengesë e rëndësishme për investimet e brendshme dhe të jashtme. Vendet në rajon duhet të shkëmbejnë praktikën më të mirë në mjedisin ligjor dhe rregullator si dhe aspekte të tjera të klimës së investimeve në mënyrë që përmirësimet mund të jetë gjithëpërfshirëse dhe të shpejta. Kjo është e rëndësishme jo vetëm për të tërhequr investitorët e huaj, por edhe për të shërbyer si një pikë referimi për reformat dhe nxitje rritjen ekonomike.

H. ÇËSHTJE STRUKTURE: VALA E DYTË E PRIVATIZIMIT?

Nën presionin e mjedisit të jashtëm dhe të ardhurave të pamjaftueshme, qeveritë e EJT6 po kërkojnë mënyra për të përmirësuar eficiencën, për të tërhequr FDI, për të ngritur eksportet dhe për të siguruar financime. Intensifikimi i procesit të privatizimit është një mundësi të cilën qeveritë po e marrin në konsideratë si pjesë e një përpjekjeje të përgjithshme për të lehtësuar kufizimet në financim dhe për të përmirësuar konkurrueshmërinë. Prandaj, qeveritë e EJT6 po kërkojnë burime kapitali jo vetëm në vendet e OECD-së por edhe në ato vende me të ardhura të mesme të pasura në burime dhe në rritje si Turqi, Rusia, Kina dhe Azerbajxhani.

Vendet e Ballkanit Perëndimor në një farë mënyre e humbën valën e parë të privatizimit në Evropën Lindore për shkak të luftërave rajonale dhe çarjet dhe çrregullimet e shkaktuara prej tyre u shtrinë në vitet 1990. Megjithatë, pavarësisht nga fillimi i vonë, privatizimi ka qenë i konsiderueshëm. Sidoqoftë, ende shumë ndërmarrje, veçanërisht në sektorët e infrastrukturës, mbeten në duart e shtetit apo kryesisht në duart e shtetit, veçanërisht në Serbi. Tani, kriza globale po i bën qeveritë të mendojnë më thellësisht rreth përfitimeve të mundshme fiskale, teknologjike, për investimet dhe vendet e punës të një vale të dytë të privatizimeve. Megjithatë presioni parësor është fiskal, ndërkohë që qeveritë përpiqen të zbatojnë konsolidime të thella dhe të ulin borxhin publik mund të ekzistojë një mundësi e re për të përdorur mësimet e nxjerra nga privatizimet e kaluara për të ngritur kapacitete të reja eksportimi, për të rritur konkurrueshmërinë dhe për të zgjeruar investimet.

Tabela 7: Privatizimet e lajmëruara në Ballkanin Perëndimor

Vendi	Kompania	Sektori/Industria
Shqipëria	Katër hidrocentrale të vegjël; Albpetrol	Energji;
Kosova	Posta dhe Telekom i Kosovës (PTK)	Telekomunikacion
Serbia	Telecom Serbia	Telekomunikacion
	JAT Airways	Transport ajror
	Galenika	Farmaceutika
	Metalurgjiku i Smederevo	Çelik
	Kompania Minerare Bor (pjesërisht)	Miniera
Maqedonia	AD OHIS	Industria kimike
	EMO Ohrid	Elektronikë
	Tutunski Kombinat AD Prilep	Industria e duhanit
	11 Oktomvri Eurokompozit Prilep	Industria e ushtarake
Mali i Zi	AD Montecargo Podgorica	Transport dhe logjistikë
	Montenegro Airlines AD Podgorica	Transport
	AD Kontejnerski terminal i generalni tereti	Transport dhe logjistikë
	AD Zora Berane	Ushqimore
	Jadransko brodogradilište“ AD Bijela	Kantier ndërtimi anijesh
	HG Budvanska rivijera AD Budva	Turizëm
	HTP Ulcinjska rivijera AD Ulcinj,	Turizëm
	Institut crne metalurgije AD Nikšić	Metalurgji
	Fabrika elektroda Piva	Elektronikë

Burimi: Stafi i Bankës Botërore, bazuar në burimet zyrtare qeveritare

Pavarësisht nga problemet e shkaktuara nga kriza, transaksionet e privatizimeve sollën më shumë se 1 miliardë USD në EJL6 në vitin 2010 - 2011 -- e barasvlerëshme me 0.6% të PBB të kombinuar në rajon. Këto transaksione u përqendruan në transportin ajror dhe industrinë e çimentos (Kosovë) dhe sektorin e çelikut dhe turizmit (Mali i Zi). Shumica e investitorëve ishin nga Turqia, por disa erdhën nga Zvicra, Katari, Greqia dhe Franca. Dy transaksione në vitin 2012 tregojnë interes në rritje në sektorin e energjisë. Për më tepër, ekziston potencial i rëndësishëm për privatizime në transport, turizëm, elektronikë dhe metale (Tabela 7)

Për të përfituar maksimumin nga privatizimet e reja, do të ishte shumë e këshillueshme qeveritë e EJL6 t'i kushtonin vëmendje të veçantë disa mësimave kryesore që të tjerët kanë nxjerrë rreth këtij procesi:

- Qasja rast pas rasti është parë si më e suksesshme: instalimi në majë të kompanisë i një investitori thelbësor, i cili ka më shumë gjasa të ristrukturojë një kompani dhe të rrisë në mënyrë të konsiderueshme produktivitetin e saj.
- Privatizimi tek të jashtmit rezulton në më shumë ristrukturim se sa privatizimi tek të brendshmit (drejtuesit dhe punonjësit). Fondet e investimeve, të huajt dhe të tjerët të cilët mbajnë blloqe të mëdha aksionesh prodhojnë më shumë ristrukturim se sa pronësi individuale të shpërndara.
- Rekomandohen tendera konkurrues për kompanitë e mëdha dhe ankande ku fituesi merr gjithçka për ndërmarrjet e vogla e të mesme, të cilat do të rezultonin në pronësi të përqendruar.
- Për kompanitë për të cilat nuk ka oferta, edhe pas përpjekjeve të përsëritura për çmim më fleksibël apo ristrukturim, duhet të lejohet falimentimi.
- Për kompanitë me humbje të mëdha, qasja e orientuar ndaj transaksioneve -- privatizim nëpërmjet ristrukturimit -- ka të ngjarë të prodhojë rezultate më të mira. Megjithatë, që transaksionet të ndodhin, ajo që do të kishte rëndësi kritike do të ishte një ndërhyrje modeste dhe e përkohshme publike për të reduktuar problemet e trashëguara dhe kufizime të ashpra buxhetore për të siguruar bashkëpunim nga drejtuesit dhe punonjësit.
- Është e rëndësishme për të bërë një analizë të kujdesshme kosto-përfitimi për të shmangur nënvlerësimin (dhe nën-buxhetimin) për të financuar programet sociale të shoqëruara me privatizimet/ristrukturimet.
- Të ardhurat e privatizimit nuk duhet të përdoren për të financuar shpenzimet publike korrente, por për të ulur borxhi publik të shtrenjtë, shlyerja e pagesave të prapambetura, ose për investime në infrastrukturë publike brenda një kornize të kujdesshme makroekonomike dhe fiskale.
- Ajo që është absolutisht themelore për privatizim të suksesshëm është një proces transparent -- një kuadër i qartë ligjor, i plotësuar nga rregullore dhe procedura të mirë-përcaktuara të cilat publikohen dhe zbatohen -- dhe siguri i kapacitetit të agjencisë së privatizimit.

I. ÇËSHTJE STRUKTURE: DEFICITI I INFRASTRUKTURËS ENERGJETIKE

Kufizimet e furnizimit me energji po shfaqen si një problem kyç strukturor në Ballkanin Perëndimor dhe energjia gjithashtu përmendet gjithnjë e më shumë si një kufizim i klimës së biznesit në studimet e kohëve të fundit për kompanitë. Investimet e pamjaftueshme dhe infrastruktura e përkeqësuar që funksionon përtej afateve të projektuara, kërcënojnë në mënyrë serioze sigurinë e energjisë


në rajon. Moti i rëndë gjatë Janarit dhe Shkurtit 2012 ishte një kujtesë e atyre që do të vijnë, meqenëse shumë vende nuk ishin në gjendje të plotësonin kërkesat e brendshme dhe shkurtuan eksportet për fqinjët. Situata ka të ngjarë të përkeqësohet ndërkohë që projekte kyç po vonohen dhe energjia e tepërt po bie në vendet të cilat importonin. Rënia e përkohshme në kërkesën për energji për shkak të krizës ekonomike ofron një lehtësim afatshkurtër, por sapo ekonomia të marrë kthesë, furnizimi me energji mund të jetë një barrierë për zhvillimin ekonomik.

Pa investime të rëndësishme në infrastrukturë, rajoni pritet të bëhet një importues neto i energjisë deri në vitin 2020 (Figura 42). Sipas Strategjisë së Energjisë të Komunitetit të Energjisë së Evropës Juglindore (2012), sipas tendencave aktuale të konsumit të energjisë, kërkesat për energji elektrike nuk do të plotësohen deri në 10 për qind në vitin 2020, dhe hendeuku ka mundësi të rritet në një nivel më të lartë në vitin 2030 (ndoshta deri në 30 për qind) Për të ruajtur bilancin ofertë - kërkesë në dhjetëvjeçarin e ardhshëm, vendet do të duhet të bëjnë investime thelbësore, rreth 44.6 miliardë Euro në sektorin energjetik dhe burime edhe më të mëdha financiare për të menaxhuar tranzicionin drejt një ekonomie me nivel të ulët të shkarkimit të karbonit. Me krizën ekonomike, kapaciteti i qeverive për të financuar investime vetë dhe për të tërhequr investime private ka të ngjarë të bëhet më e vështirë. Reforma shtesë të shtjelluara më poshtë dhe financime të jashtme dhe PPP mund të ndihmojnë në mbylljen e hendekut.

Zhvillimi i infrastrukturës moderne dhe eficiente të energjisë e cila mbështet rritjen ekonomike do të kërkojë veprime përcaktuese reformuese për të trajtuar sfidat e shumëfishta me të cilat përballet sektori energjetik:

- **Rigjallërimi i axhendës së reformave.** Vendeve të EJT6 do tu duhet të arrijnë ekonomitë e BE11 për reformat strukturore bazë të cilat krijojnë një klimë të përmirësuar biznesi për të nxitur investimet, si ato publike dhe ato private. Veprimet kyç përfshijnë zbatimin e vendosjes së çmimeve që pasqyrojnë kostot dhe heqjen e barrierave legjislative dhe rregullatore ndaj tregtisë së energjisë.

Figura 42: Importet aktuale dhe të parashikuara të energjisë (GWh)



- **Krijimi i një tregu rajonal të energjisë i cili funksionon siç duhet.** Bashkëpunimi rajonal rreth prodhimit dhe tranzitit të energjisë mund të nxisë sigurinë e ofertës dhe të krijojë kurse më të mëdha ekonomike (me rreth 10 për qind deri në vitin 2020 në prodhimin e energjisë elektrike) Sfida është zhvillimi i infrastrukturës së përshtatshme për të mbështetur tregtinë e energjisë, për të hartuar marrëveshje të menaxhimit të riskut për investitorët privatë, dhe ajo që është më e rëndësishmja, për të forcuar protokollet e reja të bashkëpunimit duke mundësuar tregtimin konkurrues me shumicë të energjisë.

- **Lidhja me potencialin e eficientës së energjisë (EE) duke reduktuar humbjen e energjisë nga ana e konsumatorëve** Ekonomitë në rajon përdorin dy herë më shumë energji për dollar të PBB se sa vendet e Evropës Perëndimore. Deri tani qeveritë janë angazhuara ndaj kursimit të energjisë me një synim tregues prej 9 për qind të konsumit final të energjisë ndërmjet viteve 2009 dhe 2018, nëpërmjet Planeve Kombëtare të Veprimit për Eficientë të Energjisë. Megjithatë, do të duhet të adresohen disa pengesa duke përfshirë: çmimet e ulëta të energjisë; informacioni i pamjaftueshëm mbi teknologjitë; shumë pak kontraktorë dhe kompani shërbimi; si dhe kufizimet në financim për zbatimin e Planeve të tyre të Veprimit.

- **Përparimi rreth kërkesave të integritetit në BE në lidhje me axhendën e ndryshimeve klimaterike.** Rajoni varet shumë nga qymyri vendas për të plotësuar nevojat e tij për energji. Kjo nuk do

të jetë një zhvendosje e lehtë për tu bërë për shkak të arsyeve të kostove dhe stabilitetit. Në të njëjtën kohë, vendet do të duhet të jenë në përputhje me kuadrot e BE për ndryshimin e klimës dhe mbrojtjen e mjedisit nëse ato do të duhet të plotësojnë ambiciet e tyre për integrim. Sfida është shumë e madhe dhe e kushtueshme dhe do të kërkojë përdorimin më të mirë të instrumenteve të financimit të karbonit dhe zbatimin e alternativave të politikave për të promovuar mundësitë e largimit nga përdorimi i karburanteve dhe për tu lidhur me potencialin e rajonit për energji të rinovueshme.

J. EJL6 PERSPEKTIVA PËR 2012–13

Perspektiva globale dhe ajo e Eurozonës që përcaktojnë zhvillimet afatshkurtra për vendet e EJL6 karakterizohet nga një ngadalësim i konsiderueshëm në rritjen globale, recesion në Eurozonë dhe një ngadalësim i madh në shkëmbimet tregtare në Eurozonë (Tabela 8 dhe Figura 43). Për shkak të preqshmërisë të lartë të vendeve të EJL6, për rajonin këto zhvillime po përkthehen në një recesion aktual dhe prospekte më të vështira afatshkurtra.

Tabela 8: Rritja Globale dhe Rajonale


Rritja Reale e PBB (në përqindje)

	2008	2009	2010	2011	2012e	2013f	2014f	2015f
Bota	1.4	-2.2	4.0	2.8	2.3	2.4	3.1	3.4
Të ardhura të larta	0.1	-3.5	2.9	1.6	1.3	1.3	2.0	2.3
Vendet në zhvillim	5.8	1.8	7.4	6.2	4.9	5.5	5.8	5.9
<i>Memo item</i>								
Zona e Euros	0.3	-4.3	2.0	1.5	-0.4	-0.1	-0.9	1.4

Burimi: Vlerësimet e stafit të Grupit të Prospekteve Ekonomike Globale të Bankës Botërore Paraprake, sipas dhjetor 13 2012.

Edhe me rimëkëmbjen në gjysmën e dytë të vitit, rajoni në tërësi do të mbetet në recesion gjatë vitit 2012 me rritjen e që pritet të mbetet e dobët në për vitin 2013 në 1.6 për qind. Rritja pritet të ngrihet për shkak të një rimëkëmbje të bujqësisë, rritjes së eksporteve të makinave nga Serbia dhe disa lehtësime të kushteve të jashtme dhe të brendshme të kërkesës (Tabela 9), duke supozuar që rreziqet për Eurozonën dhe ekonominë globale nuk materializohen. Rritja ekonomike në 2013 parashikohet të jetë më e ulët në BiH (0.5 për qind), dhe përsëri më e lartë në Kosovë (3.3 për qind). Rritja

Figura 43: Prodhimi Industrial dhe Tregtia në BE



ekonomike e Serbisë pritet të arrijë rreth 2 për qind në vitin 2013, e shtyrë kryesisht nga përsheptimi i eksporteve dhe zinxhiri i prodhimit nga uzina e madhe FIAT dhe nga një rekuperim ciklik bujqësor. Por rritja nuk do të jetë e mjaftueshme për të lënë gjurmë në papunësi, e cila mund edhe të vazhdojë të rritet.

Prandaj perspektiva afatshkurtër ekonomike dhe sociale për EJL6 është e vështirë. Ulja e kohëve të fundit e rritjes të eurozonës, e cila është reflektuar në parashikimet e këtij raporti, sugjeron vazhdimin e ambientit të vështirë të jashtëm për vendet e EJL6. Por dobësitë e tyre të brendshme do të rëndojnë shumë në perspektivën afat të shkurtër. Në vendet me borxh publik të lartë që janë mbështetur kryesisht mbi kërkesën e jashtme për rimëkëmbje (BiH, Mali i Zi, Serbia dhe deri në një farë mase Shqipëria), rritja do të jetë e ngadaltë. Financat publike do të vazhdojnë të mbeten nën presion në gjithë EJL6 edhe në 2013. Problemi i papunësisë është kthyer në një krizë masive sociale, vështirë se do të reduktohet deri në kthimin e një rritjeje më të fortë ekonomike që absorbon vende pune.

Tabela 9: Perspektiva e Rritjes e EJL6 për vitet 2012-13

	2011	2012 (proj.)	2013 (proj.)
SHQ	3.0	0.8	1.6
BiH	1.3	0.0	0.5
KOS	5.0	3.6	3.3
MKD	2.8	0.0	2.0
MZI	2.5	0.2	1.0
SRB	1.6	-2.0	2.0
EJL6	2.2	-0.6	1.6
BE11	3.1	0.9	1.3
<u>BE15</u>	1.5	-0.4	1.0

Burimi: Banka Botërore Për BE15, Komisioni Evropian

K. PËRSHPEJTIMI I REFORMAVE, MOBILIZIMI I FINANCIMEVE

Për shkak të parashikimeve të vështira, sfida kryesore politike afatshkurtër për vendet e EJL6 është se si të balancojnë nevojën për konsolidim të vazhdueshëm fiskal dhe reforma strukturore me nevojën edhe më të madhe për të rindezur rritjen dhe krijimin e vendeve të punës. Gjetja e këtij ekuilibri do të jetë i vështirë për shkak të recesionit dhe rritjes së ulët rajonale dhe në Eurozonë, financimin e kufizuar për investime, papunësinë e lartë dhe kërkesën e dobët të jashtme. Për më tepër, nëse materializohen rreziqet globale (gremina fiskale në SHBA dhe çmimet e lëndëve të para) dhe rajonale (pasiguritë e Eurozonës), ato mund t'i shtojnë ekonomitë e EJL6 drejt një recesionit të zgjatur me pasoja të konsiderueshme ekonomike dhe sociale.

Për të zbutur këtë raund të dytë të recesionit dhe parashikimet e dobëta afatshkurtra të rritjes ekonomike, vendeve të EJL6 është e qartë që do t'i duhet të rrisë përpjekjet fiskale dhe të politikave strukturore: kohët e vështira kërkojnë përpjekje më të mëdha dhe më efektive politike. Konsolidimi fiskal do të duhet të vazhdojë. Reformat e tregut të punës, klimës së investimeve dhe sektorit publik duhet

të përshpejtohen. Kjo axhendë e pranuar makroekonomike dhe strukturore për Ballkanin Perëndimor (shikoni raportet e EJT RZHE të Nëntorit 2011 dhe Qershorit 2012) po bëhet më urgjente për shkak se kushtet janë më të vështira. Gjithashtu, zbatimi i kësaj axhende të reformave -- dhe sigurimi i rezultateve të monitorueshme -- do të jenë çelësi (dhe pjesë) e çdo rritje të mundshme të financimit të jashtëm për rritje ekonomike dhe vende pune që sugjerohet më poshtë. Axhenda e reformave mund të përfshijë:

- *Reforma të Tregut të Punës:* Papunësia e rëndë dhe e vazhdueshme, veçanërisht në radhët e grupeve të prekshme, kërkon reforma të guximshme të tregut të punës në EJT. Bërja e kushteve të tregut më fleksibël do të ndihmojë këto vende që të zgjidhin ngurtësitë strukturore në tregjet e tyre të punës. Tërheqja e grave në fuqinë punëtore do të jetë një sfidë madhore, e cila mund të lehtësohet nëpërmjet rritjes e mjediseve për mbajtjen e fëmijëve të vegjël.
- *Reformat arsimore:* Reformat për përmirësimin e cilësisë së arsimit të mesëm dhe të lartë, trajtimin e mospërputhjes së aftësive dhe rritja e "fleksigurisë" (kombinimi i fleksibilitetit dhe sigurisë) së tregut të punës janë thelbësore për përmirësimin e rezultateve të fuqisë punëtore por do të kërkojnë kohë.
- *Integrimi i tregtisë, mjedisi i biznesit dhe konkurrenca:* Thjeshtëzimi i rregullave të biznesit, trajtimi i problemeve të qeverisjes dhe zbatimi i kontratave dhe të drejtave të pronësisë janë fusha ku vendet e EJT6 mund të zbatojnë reforma për rezultate të shpejta. Rajoni gjithashtu mund të përfitojë nga harmonizimi i rregulloreve përtej kufijve dhe thellimi i integritetit tregtar dhe financiar. Hapja e tregjeve dhe mundësive për zhvillimin e biznesit -- p.sh., nëpërmjet privatizimit dhe në monopolet e rregulluara tradicionalisht si energjia, elektriciteti dhe hekurudha -- janë ndërmjet fushave ku nevojiten përpjekje të përbashkëta.
- *Rrjetat e sigurisë sociale dhe përfshirja sociale:* Përtej ofrimit të një rrjete sigurie për të papunët në kohë krize, asistenca sociale mund të bëhet më efiçente duke targetuar më mirë grupet vulnerabël, duhet të shmangë krijimin e një kurthi varfërie. Politikat e aktivizimit në kombinim me asistencën e targetuar sociale duhet të parandalojnë që papunësia e përkohshme të zhvillohet në një varësi afatgjatë. Asistenca sociale e mirë-projektuar dhe e mirë-ofruar mund të rrisë stimujt që njerëzit të punojnë.

Për të mbështetur këto reforma të intensifikuara, vendet e EJT6 mund të përfitojnë nga financimi i jashtëm për rritje ekonomike, infrastrukturë dhe vende pune. Në 8 Nëntor 2012, BEI, BERZH dhe Banka Botërore shpallën nismën "Plani i Përbashkët i Veprimit për Rritjen në Evropën Qendrore dhe Lindore" për të ofruar 30 miliardë euro në financim për Evropën Qendrore dhe Lindore në mbështetje të rritjes dhe vendeve të punës. Ky financim mund të jetë i disponueshëm për vendet e EJT6 nëpërmjet Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor dhe dhe IFI të tjerë si kanale të mundshme. Financimi IPA është gjithashtu shumë i rëndësishëm për të mbështetur reformat institucionale, bashkëpunimin rajonal, zhvillimin ekonomik, social dhe rural.

2. MENAXHIMI I VULNERABILITETIT NDAJ TRONDITJEVE TË ÇMIMEVE TË USHQIMEVE NË EJL6¹²

Rritja e shpejtë e çmimit të ushqimeve gjatë muajve të verës 2012 ka tërhequr një vëmendje të konsiderueshme në gjithë botën, meqenëse kujtesa e varfërisë në rritje dhe turbullirave politike dhe sociale gjatë krizës ushqimore 2007-2008 mbetet ende e freskët. Një kombinim i tronditjeve negative të motit dhe stokeve historikisht të ulëta të mallrave, së bashku me hapësirën e kufizuar fiskale për masa zbutëse, e bën më të vështirë mbrojtjen e familjeve të varfra dhe vulnerabël nga pasojat negative të rritjes së menjëhershme të çmimit të ushqimeve. Megjithatë rajoni i EJL6 ka qenë më i izoluar nga luhatjet në çmimet botërore në të kaluarën, tendencat e konsumit, veçanërisht ndërmjet të varfërve, mund të bëjnë edhe rritjet relativisht të vogla në çmimet e ushqimeve të vështira për tu përballuar. Kalimi nga çmimet botërore te ato lokale gjatë periudhës më të fundit (2011-2012) vazhdoi të mbetet i ulët për shumicën e vendeve të EJL6, me përjashtim të Kosovës dhe Serbisë ku më shumë se 50% e rritjes botërore në çmimet e ushqimeve u pasqyrua në çmimet e brendshme. Për shkak të pjesës më të lartë që zë ushqimi në buxhetet familjare, familjet në pjesën fundore të shpërndarjes së mirëqenies ka të ngjarë të preken më shumë nga këto rritje. Simulimet e bazuara në të dhënat e studimeve të familjeve sugjerojnë që një rritje 5% në çmimet e ushqimeve (e ngjashme me nivelet e përjetuara në vendet e EJL në vitin 2011) mund të rrisë nivelin e varfërisë me 2 pikë të plota përqindjeje në Kosovë dhe Maqedoni, me ndikime më të vogla në vendet e tjera të EJL6. Paqëndrueshmëria më e lartë e çmimeve të mallrave do të kërkojë një përgjigje politike të bashkërenduar e cila duhet të kombinojë forcimin e vazhdueshëm të kapacitetit të rrjetave të sigurisë sociale për t'ju përgjigjur krizave dhe programet bujqësore që synojnë mundësimin e kësaj përgjigjeje nga oferta.

A. HYRJE

Çmimet e ushqimeve po vëzhgohen nga afër në gjithë botën. Për shkak se rritja e tyre e shpejtë në vitet 2007-2008 solli një rritje të varfërisë dhe madje turbullira politike dhe sociale në një numër vendesh, rritja e fortë e çmimeve të ushqimeve këtë verë ringjalli shqetësime që nuk mund të davaritë as një rënie e pritshme e moderuar e çmimeve. Vera e 2012 ofroi rritje të çmimeve të drithërave deri në nivelet e vitit 2008 për shkak të motit të pafavorshëm në shumicën e vendeve eksportuese të grurit. Dështimi i të korrave të grurit në Rusi shkaktoi një rritje të çmimit të grurit deri në nivelin më të lartë të 4 viteve në Nëntor 2012. Kjo është shfaqja e fundit e paqëndrueshmërisë që ka karakterizuar tregjet e mallrave, veçanërisht ushqimeve, në dhjetëvjeçarin e fundit dhe i ka bërë familjet shumë më të prekshme nga tronditjet e çmimeve të ushqimeve. Përveç ndikimeve të motit të keq të kohëve të fundit, stoqet globale të grurit janë të ulëta sepse në dy nga tre vitet e fundit të korrat kanë qenë të këqija. Gjithashtu, në shumë vende konsolidimi fiskal kufizon rëndë hapësirën e qeverisë për të miratuar masa zbutëse ndërkohë që disa masa nga prodhuesit më të mëdhenj të grurit (p.sh., ndalimi i eksportit nga Ukraina, i vendosur në Tetor) mund të kontribuojnë presion shtesë për ngritjen e çmimeve. Meqenëse çmimet e ushqimeve parashikohen të mbeten të larta gjatë gjithë vitit 2013, është e përshtatshme të merret në konsideratë se sa gati mund të jenë vendet për të përballuar një botë të çmimeve ushqimore të larta dhe shumë të paqëndrueshme dhe për të trajtuar ndikimet e tyre të mundshme mbi të familjet e varfra dhe vulnerabël.

Në 2007-08, rajoni i EJL6 u prek më pak se pjesë të tjera të Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore nga rritja në çmimet globale të ushqimeve, por kjo mund të mos jetë njësoj në vitin 2013. Ushqimet janë një pjesë e rëndësishme e shpenzimeve të familjeve në vendet e EJL6, veçanërisht për disa nga

¹² Ky kapitull u shkrua nga Alexandru Cojocaru, Caterina Ruggeri Laderchi, dhe Ken Simler (Evropa dhe Azia Qendrore, Reduktimi i Varfërisë dhe Menaxhimi Ekonomik). John Baffes (Grupi i Prospektive Ekonomike të Zhvillimit) kontribuoi me një dokument mbi dinamikën globale të çmimeve të ushqimeve.

grupet më vulnerabël, kështu që edhe rritje të vogla mund të vështirësojnë jetën e një numri të madh familjesh--veçanërisht meqenëse pas viteve të rritjes së ngadaltë familjet e EJL6 mund t'i kenë shteruar strategjitë e përballimit të jetesës. Gjithashtu, rritjet e mundshme të çmimeve të tjera, si energjisë, mund të shtojnë barrën mbi buxhetet e tyre. Së fundmi, këtë verë rajoni i EJL6 u godit drejtpërdrejt nga moti i keq, duke e bërë ndikimin global më të fortë se gjatë krizës së fundit.


Ky dokument ofron një këndvështrim global dhe rajonal mbi zhvillimet e çmimit të ushqimeve, duke theksuar faktorët e vulnerabilitetit në vendet e EJL6 dhe masat për menaxhimin më të mirë të paqëndrueshmërisë së çmimit të ushqimeve në të ardhmen. Për të matur shtrirjen e ndikimeve sociale të paqëndrueshmërinë e çmimit të ushqimeve ne simulojmë ndikimin e zhvillimeve të çmimeve të ngjashme me ato të përjetuara në vitin 2011. Në këtë skenar, edhe nëse jo të gjithë vendet shohin rritje të mëdha në varfëri, nëse ka një tronditje ushqimore grupet vulnerabël ka të ngjarë të jenë nën një presion të madh gjatë një tronditjeje ushqimore. Së fundmi, ne diskutojmë se si vendet e EJL6 mund të përshtaten me mjedisin e ri të paqëndrueshmërisë së çmimit të ushqimeve dhe të sigurojnë një përgjigje të përshtatshme nëse materializohen rreziqet e rritjeve të mëtejshme të çmimit të ushqimeve.

Një Perspektivë Globale mbi Çmimet e Ushqimeve

Që në mesin e viteve 2000 çmimet e ushqimeve janë rritur në mënyrë themelore në gjithë botën, dhe paqëndrueshmëria e tyre është përkeqësuar. Pas një periudhe të stabilitetit relativ¹³, praktikisht të gjithë çmimet e mallrave filluan të rriten në mesin e viteve 2000 (Figura 44). Deri në Qershor 2008 vlera e Treguesit të Çmimit të Ushqimeve i Bankës Botërore u rrit me 129% krahasuar me Janar 2005. Pjesa më e madhe e rritjes ndodhi në një periudhë të shkurtër në gjysmën e dytë të vitit 2007 dhe gjysmën e parë të vitit 2008. Ndërkohë që fillimi i Recesionit të Madh global ushtron presion mbi çmimet e tyre, stoqet e ushqimeve mbetën të ulëta, duke i lënë vendet vulnerabël ndaj rritjeve të reja të çmimeve.

Jo vetëm që çmimet u rritën, edhe paqëndrueshmëria e tyre u rrit. Figura 45 ilustron shpërndarjen në rritje në vitet e fundit për treguesin e përgjithshëm të çmimit të ushqimeve dhe treguesit për grurin dhe vajrat. Si treguesi Theil ashtu dhe koeficienti i ndryshimit¹⁴ për tre

Figura 44: Çmimet e Drithërave dhe Vajrave Ushqimorë, Nominale dhe Reale në USD (2005=100)




Burimi: Banka Botërore DECPG

¹³ Kjo erdhi pas rreth tre dekadave të rënies së çmimit të mallrave, veçanërisht për ushqime: ndërmjet niveleve të ulëta të viteve 1974 dhe 2000, çmimet botërore të ushqimeve ranë me 70% në terma realë të USD.

¹⁴ Koeficienti i ndryshimit, i përkufizuar si raporti i devijimit standard ndaj mesatares, është një masë e normalizuar e shpërndarjes. Vini re që për vitin 2012 janë përdorur vetëm tetë muajt e parë të vitit.

grupet (por veçanërisht për vajrat dhe treguesin e e përgjithshëm të ushqimeve) tregojnë paqëndrueshmëri më të lartë pas vitit 2005, jo vetëm duke ju afruar krizës ushqimore të viteve 2007/2008 por gjithashtu dhe më vonë¹⁵.

Figura 45: Paqëndrueshmëria e Çmimit: Koefficienti Vjetor i Ndryshimit dhe Treguesi Theil për Çmimet e Ushqimeve, 1990-2012



Burimi: Vlerësime të stafit të Bankës Botërore bazuar në të dhënat e FAOSTAT

Shkaqet e bumit të mallrave ishin të shumta, duke u luhatur nga faktorë makro dhe afatgjatë deri tek ato specifike të sektorëve dhe afatshkurtër. Në pjesën e parë të viteve 2000 shumica e vendeve, veçanërisht ato në zhvillim, kanë përjetuar rritje ekonomike të qëndrueshme dhe solide. Zhvlerësimi i dollarit amerikan -- monedha e zgjedhur për shumicën e transaksioneve ndërkombëtare të mallrave -- nxiti kërkesën nga dhe kufizoi ofertën për konsumatorët dhe prodhuesit e mallrave që nuk ishin në USD. Faktorë të tjerë kontribuues ishin investimet e ulëta të kaluara, veçanërisht në mallrat minerare (një përgjigje ndaj një periudhe të zgjatur të çmimeve të ulëta); likuidet e larta të pazakontë global; aktivitetet e fondeve të investimeve nga institucionet financiare që zgjodhën të shtojnë mallrat në portofolet e tyre; dhe shqetësimet gjeopolitike, veçanërisht në tregjet e energjisë.

Çmimet e mallrave bujqësore u ndikuan në mënyrë të veçantë nga kostot më të larta të energjisë, kushte të papritura të shpeshta të motit të keq dhe devijimi i disa mallrave ushqimore drejt

¹⁵ Të dy treguesit raportojnë vlera vjetore të bazuara mbi të dhënat mujore të çmimeve.

prodhimin të biokarburanteve¹⁶. Përgjigjet politike e acaruan rritjen e çmimeve. Energjia është ndoshta inputi më i rëndësishëm në mallrat bujqësore, si drejtpërdrejt nëpërmjet karburantit ashtu dhe tërthorazi nëpërmjet inputeve që kërkojnë shumë energji siç janë kimikatat dhe plehrat. Si një rezultat, raportet globale të stokut ndaj përdorimit të disa mallrave bujqësore ra në nivele që nuk ishin parë që në fillim të viteve 1970. Shumë vende miratuan ndalime të eksporteve dhe taksa penguese për të kompensuar ndikimin e çmimeve botërore në rritje mbi tregun vendas. Për shembull, kufizimi i eksportit të grurit i vendosur nga Ukraina, i kombinuar me prodhimin e varfër që lidhet me thatësinë në Australi, ka sjellë kufizime të eksportit në prodhuesit kryesorë si Rusia, Kazakistani dhe Argjentina. Efekti ishte një rritje prej 45% në çmimet e grurit ndërmjet Tetorit 2007 dhe Shkurtit 2008 (Headey dhe Fan 2010: 48).

Që nga viti 2010 çmimet globale të ushqimeve kanë qenë të larta dhe në verën e vitit 2012 ato arritën majat, të ndjekura nga një tronditje e re në Nëntor 2012. Çmimet më të larta të naftës të kombinuara me tronditjet e motit i ngritën çmimet e ushqimeve në gjysmën e dytë të vitit 2010 dhe deri në Shkurt 2011 Treguesi i Çmimit të Ushqimit i Bankës Botërore e kapërceu kulmin e tij të vitit 2008. Më vonë në vitin 2011 çmimet e ushqimeve u zbutën meqenëse kushtet dukeshin premtuese për të korrat e 2011/2012 dhe Rusia e hoqi ndalimin e eksportit. Por perspektiva përsëri u kthye në negative në verën e vitit 2012 pas lajmeve të problemeve të motit. Aksionet e misrit dhe grurit fituan secili 40% nga mesi i Qershorit në mesin e Korrikut (Figura 46). Në Korrik dhe Gusht Treguesi i Çmimit të Ushqimit i Bankës Botërore dhe treguesit për drithërat dhe vajrat dhe yndyrat arritën përsëri kulmin e vitit 2008. Rritja erdhi si rezultat i kushteve të nxehta dhe të thata në SHBA (misri) dhe motit të keq në Rusi dhe në një shkallë më të vogël në Evropën Perëndimore (gruri). Pas rënies së mëdha të verës në parashikimin global të drithërave, parashikimi i Tetorit mbeti i pandryshuar. Megjithatë tronditjet e mëdha të motit që do të kishin ndikuar mbi prodhimin në hemisferën e jugut nuk janë materializuar ende, shqetësimet rreth një shtrëngese të re të tregut bazuar mbi konsumin e pritshëm rezultuan në një ngritje tjetër të çmimit. Njoftimi i kohëve të fundit për një dështim të të korrave në Rusi rezultoi në një rritje të re të çmimeve të grurit në Nëntor 2012.

Që nga ngritja e fundit e çmimeve të ushqimeve, raportet stok-përdorim për misrin dhe grurin kanë rënë në nivele të ulëta historike. Kjo do të thotë që edhe një tronditje e vogël e ofertës mund të shkaktojë një ngritje të madhe të çmimeve, veçanërisht për shkak se çmimet e larta të naftës mund ta bëjnë etanolin me bazë misrin një alternativë tërheqëse. Për shembull, stoqet e 2012/13 për misrin priten të jenë 13.7%, ose 10.8% më pak se stina e fundit (dhe 18.6% më pak se vlerësimi i muajit Maj 2012--niveli më i ulët që nga viti i të korrave 1972/2, dhe pothuajse 3 pikë përqindje më i ulët se në vitin 2007/2008). Megjithatë stoqet e

Figura 46: Çmimet e Aksioneve të Misrit dhe Grurit (cent të USD për shinik)



Burimi: Banka Botërore DECPG

¹⁶ Kjo përfshinte misrin në SHBA dhe vajrat ushqimore në Evropë, megjithatë zhvendosja e të korrave çoi në çmime më të larta për produkte të tjera si soja dhe gruri.

grurit pritet të ulen me pothuajse 13% nga stina e fundit, tregu i grurit duket që është më i furnizuar, raporti stok-përdorim llogaritet në nivelin 25.4%, më shumë se 5 pikë përqindje më e lartë se në vitin 2007/08.


Parashikimi aktual global është që çmimet do të bien nga kulmi i tyre i vitit 2012 por do të qëndrojnë shumë më lart se nivelet e vitit 2012, gjatë gjithë vitit 2013, por ekzistojnë ende rrezeqe të konsiderueshme për shkak të motit dhe veçanërisht çmimeve të naftës. Për shkak se disa tronditje të motit që priteshin më përpara nuk janë materializuar ende, parashikimet më të fundit të çmimeve shohin një rënie prej 16 pikë përqindjeje në treguesin e ushqimit të Bankës Botërore--por kjo ende do të thotë që do të jetë 28 pikë përqindjeje më i lartë se në vitin 2010, përpara ngritjes aktuale të çmimeve. Dinamika e çmimeve të naftës janë gjithashtu një shkak i paqëndrueshmërisë, megjithëse ngadalësimi në ekonominë globale mund të zbutin disa nga ndikimet e saj.

Ekzistojnë disa ngjashmëri shqetësuese ndërmjet krizës ushqimore të vitit 2007/2008 dhe ngritjes së fundit të çmimeve të ushqimit. Të dyja episodet karakterizoheshin nga stoqe të ulëta të grurit, çmime të naftës në rritje, norma të paqëndrueshme këmbimi dhe investime të konsiderueshme financiare në mallrat bujqësore. Megjithatë, episodi i fundit dallon nga 2007/2008 në disa aspekte kyç. Rritjet aktuale e çmimeve ushqimore duket që janë më të shtrira në mallrat bujqësore se sa në vitin 2007/2008; paqëndrueshmëria e motit është shumë më e rëndësishme sot, dhe përgjigjet e politikave tregtare janë relativisht më pak të rëndësishme. Së fundmi, shumë më shumë eksporte sot kanë origjinën në më shumë kushte të paqëndrueshme rritjeje jashtë vendeve vendeve të zhvilluara (Banka Botërore 2011a).

Rritjet e Çmimit të Ushqimeve nga Këndvështrimi i EJL6

Rajoni i EJL mund të jetë tani më vulnerabël ndaj rritjeve të çmimit të ushqimit se sa në të kaluarën (Figura 47). Që në Janar Serbia ka përjetuar rritjet më të mëdha në çmimet e ushqimeve dhe çmimet e ushqimeve pritet të vazhdojnë të rriten më shpejt se në vendet e tjera në rajon deri në fund të vitit. Ndërmjet Dhjetorit 2011 dhe Shtatorit 2012 çmimet nominale të ushqimit u rritën me 1 për qind ose më pak në Shqipëri dhe BiH (Gusht), 2.5 për qind në Malin e Zi, 2.6 për qind në Kosovë, 3.9 për qind në Maqedoni -- dhe me 15 për qind në Serbi, ku çmimet e Shtatorit ishin 6.3 për qind më të larta se në Qershor. Situata e Serbisë ishte deri në një farë niveli e krijuar nga thatësira e fundit: prodhimi i misrit, eksporti më i madh i vendit, pritet të shkojë vetëm në 3.5-4 MT këtë vit -- një rënie masive nga vlerësimi në

Figura 47: Treguesit e çmimeve të ushqimeve për vendet e EJL; bazë vjetore



Burimi: Zyrtar Kombëtare të Statistikave

pranverë prej 7 MT ose sasia 6.3 MT e arritur në vitin 2011. Në gjysmën e dytë të vitit 2012, bazuar në tendencat e fundit dhe parashikimet e fundit globale, çmimet e agreguara të ushqimeve mund të pritet të rriten me rreth 1 për qind në Malin e Zi, 2 për qind në BiH dhe Maqedoni, 3 për qind në Shqipëri, 5 për qind në Shqipëri dhe 6 përqind në Serbi.

Çmimet e ushqimeve u rritën më pak në EJL se sa rritja globale me 16 pikë përqindjeje ndërmjet Dhjetorit 2011 dhe Shtatorit 2012 (10 përqind e asaj ndërmjet Qershorit dhe Shtatorit). Kjo vjen pjesërisht për shkak se ushqimet e konsumuara në vendet me të ardhura më të ulëta kryesisht prodhohet në nivel lokal, kështu që kalimi nga çmimet botërore tek ato vendore ka tendencë të jetë më i ulët se sa për mallrat e tjera¹⁷. Tabela 10 tregon vlerësimet e kalimit të çmimeve ndërkombëtare për ushqimet bazuar mbi të dhënat për dy periudha të fundit të rritjes së çmimeve në EJL6. Vlerësimet pasqyrojnë një kombinim të faktorëve strukturorë (p.sh. importues neto apo eksportues neto) dhe ata kontekstualë (thatësira që preku rajonin, veçanërisht Serbinë). Serbia dhe Kosova përjetuan më shumë kalim çmimesh. Për vendet për të cilat ka më shumë të dhëna të disagreguara mbi artikujt ushqimorë (Shqipëria, BiH dhe Serbia) mallrat më të prekura ishin pijet (çaj dhe kafe), të ndjekura nga vajrat ushqimorë dhe pastaj drithërat.

Tabela 10: Vlerësimet e Ndryshimeve (Përqindje) të Çmimeve Botërore dhe Vendore të Ushqimeve dhe Kalimit

	Rritja Mesatare në Çmimet e Ushqimeve		Kalimi i vlerësuar	
	2005/06 në 2007/08	2009/10 në 2011/12	2005/06 në 2007/08	2009/10 në 2011/12
Bota	54,5	28,2		
Shqipëria	6,4	8,5	0,12	0,3
BiH	14,5	6,1	0,27	0,22
Serbia	na	na	17,1	0,61
Maqedonia	12,8	6,6	0,23	0,23
Kosova	10,9	15	0,20	0,52
Mali i Zi	11,9	3,5	0,22	0,12

Burimi: Vlerësimet e stafit bazuar në të dhëna mujore kombëtare të çmimeve dhe çmimet botërore nga DECPG. Të dhënat deri në Qershor 2011 për Shqipërinë, BiH dhe Serbinë dhe 2011 vetëm për Maqedoninë, Kosovën dhe Malin e Zi. Rritja në çmimet botërore për 2009/10 deri në 2011 ishte 29.1.


Megjithatë, ndërkohë që vendet e EJL6 mund të kenë qenë deri tani të mbrojtura nga rritjet ndërkombëtare të çmimeve të ushqimeve, nuk do të ishte e zgjuar të nënvlerësonim vulnerabilitetin ndaj tyre. Një pjesë e vulnerabilitetit është strukturor, meqenëse të gjithë vendet në rajon përveç Serbisë janë importues neto të drithërave dhe prandaj, nëse gjithçka tjetër mbetet konstante, janë të ekspozuar ndaj tekave të këtij segmenti të madh të tregut ndërkombëtar Mali i Zi, një shembull i skajshëm, varet nga importet praktikisht për të gjithë konsumin e tij të drithërave.

Gjatë krizës së ushqimeve 2007/08 vendet e EJL6 përfituan nga vlerësimi i monedhave të tyre

¹⁷ Baffes dhe Gardner (2003) vlerësojnë që ndryshueshmëria e çmimeve botërore të mallrave shpjegon rreth 27 përqind të ndryshueshmërisë në çmimet vendore.

vendase ndaj USD, duke ndjekur euron, në kushtet e tanishme ka pak të ngjarë që lëvizjet e kursit të këmbimit mund t'i mbrojnë ato nga tronditjet e ushqimit¹⁸. Ndërmjet Janarit 2006 dhe kulmit të krizës së ushqimit në Qershor 2008, euro u vlerësua me rreth 30 % kundrejt dollarit; po ashtu dhe dinari serb; dhe leku shqiptar u vlerësua me rreth 23 përqind. Megjithatë, sot nuk është e qartë se sa dinamika e kursit të këmbimit të euros mund të ndihmojë izolimin e vendeve të EJT6 nga çmimet ndërkombëtare në rritje të ushqimit.

Figura 48: Vulnerabiliteti i Familjeve ndaj Tronditjeve Globale të Cmimit të Ushqimeve, BE dhe Evropë dhe Azi Qendrore



Burimi: Përshtatur nga Townsend, Zorya, Ceccacci, Bora dhe Delgado (2011).

Edhe rritjet relativisht të përmbajtura të çmimeve mund të shkaktojnë varfëri të konsiderueshme në EJT6. Niveli deri në të cilin familjet janë vulnerabël varet kryesisht nga katër faktorë: shkalla e rritjes së çmimeve; cila pjesë e buxhetit të familjes i kushtohet ushqimit; nëse ushqimi blihet apo prodhohet vetë; dhe nëse çmimet i prekin familjet vetëm si konsumatorë, apo si konsumatorë dhe prodhues bashkë. Niveli deri në të cilin familjet mund të zëvendësojnë artikuj të ndryshëm ushqimorë gjithashtu bën

¹⁸ Kosova dhe Mali i Zi varen nga euro, dhe BiH (mark) dhe Maqedonia (denar) e fiksojnë monedhën e tyre me euron. Deri kohët e fundit Serbia e fiksonte dinarin me euron por është zhvendosur drejt fleksibilitetit më të madh si pjesë e trajtimit të inflacionit.


dallimin në atë se sa familjet mund të përballojnë një tronditje kur çmimet për artikuj të ndryshëm ushqimorë nuk rriten njëtrajshmërisht, por ky faktor mund të jetë më pak i rëndësishëm tani sepse familjet të cilat kanë bërë ndryshime të rëndësishme në konsum në vitet e fundit mund ta kenë të vështirë të bëjnë ndryshime të mëtejshme. Figura 48 trajton vulnerabilitetin e familjeve duke u bazuar në treguesit e ekspozimit të vendeve ndaj një tronditjeje çmimesh dhe përqindja marxhinale e ushqimit për familjet¹⁹ për vendet në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore (ECA) dhe BE. Këta dy tregues kapin vulnerabilitetin si (a) një përqindje më e lartë e importeve neto të drithërave ndaj konsumit për një vend nënkupton, nëse gjithçka tjetër është njësoj, një kalim më i madh nga çmimet globale të ato vendeve, dhe (b) sa më shumë familjet harxhojnë për ushqim për një njësi të ardhurash aq më shumë fuqia e tyre blerëse do të gërryhet nga një rritje çmimesh. Përgjithësisht, në vendet e ECA, familjet kanë tendencë të shpenzojnë përpjestueshmërisht më shumë për ushqim se sa në anëtarët e BE më në përfundim.

Brenda rajonit të EJT6, nga të dhënat e disponueshme, Shqipëria dhe BiH ka mundësi të jenë shumë vulnerabël për shkak të përqindjeve më të larta të ushqimit në buxhetet e familjeve dhe varësi më e madhe nga importet e drithërave. Serbia nga ana tjetër është një eksportuese neto e drithërave dhe familjet atje kanë tendencë të shpenzojnë më pak nga buxheti i tyre për ushqime, kështu që mund të jenë më pak vulnerabël. Ndërkohë që Figura 48 përqendrohet mbi vulnerabilitetin e familjeve mesatare, ka të ngjarë që grupe të ndryshme kanë nivele shumë të ndryshme të vulnerabilitetit. Kjo eksplorohet në Figurën 49 e cila gjurmon përqindjet aktuale për ushqim (d.m.th. përqindjen e konsumit total që shkon për ushqim) për çdo decil të shpërndarjes të të ardhurave. Siç pritet, përqindja e ushqimit në buxhetet e familjeve është edhe më i lartë në pjesën e poshtme të shpërndarjes së mirëqenies, kështu që edhe lëvizjet e vogla në çmime mund të ushtrojnë stres të konsiderueshëm mbi familjet e varfra. Në nivel global, familjet në vendet e EJT6 nuk janë aq vulnerabël sa ato në shumë vende në Afrikë apo Azi, por janë përgjithësisht më vulnerabël se sa në vendet e OECD apo Amerikë Latine.

Vulnerabiliteti i familjeve ndaj rritjeve të çmimeve e bën të mundshme që çmimet më të larta të ushqimit do të shkaktojnë më shumë varfëri. Për shembull, Ivanic dhe Martin (2008) vlerësojnë që ndikimi i varfërisë nga rritjet e 2005–2007 në çmimet e mallrave ishte 2.5 pikë përqindjeje në zonat rurale dhe 3.6 pikë përqindjeje në zonat urbane (megjithëse 0.3–0.4 pikë përqindjeje më i ulët pas konsiderimit së familjeve që prodhojnë mallra).

Duke përdorur të dhënat e fundit

Figura 49: Përqindjet e Buxhetit Ushqimor sipas Decileve të Konsumit



Burimi: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore bazuar në të dhënat e studimeve të familjeve (Shqipëria LSMS 2008; BiH HBS 2007; të dhënat e HBS 2010 për Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë dhe Serbinë).

¹⁹ Përqindja marxhinale e ushqimit përfaqëson përqindjen e një dollari shtesë të ardhurash të caktuar për ushqim, pije dhe duhan në buxhetin e përgjithshëm të familjes

të disponueshme, ne vlerësojmë një ndikim varfërie prej 2.5 US\$/ditë dhe 5 US\$/ditë nga një rritje prej 5 % në çmimet e ushqimeve në vendet e EJT, e cila është e krahasueshme me rritjet e përjetuara në vitin 2011 (shikoni Kutinë 5 për supozimet e bëra). Për shkak të natyrës së supozimeve tona, vlerësimet në tekst kanë të ngjarë të jenë vlerësime të pjesës më të lartë.

Kutia 5: Supozimet në Bazë të Vlerësimit të Ndikimit të Varfërisë

1 Ne marrim parasysh shpenzimet totale për ushqim dhe jo mallrat individuale, pjesërisht për shkak se rritjet e kohëve të fundit në çmimet e ushqimeve kanë bazë më të gjerë se ato në 2007-2008 (Bank Botërore 2011).

2 Në përputhje me studimet e mëparshme, ne marrim parasysh ndikimin jetëshkurtër të ndryshimeve në çmime në mënyrë që të veçojmë çdo ndikim zëvendësues afatgjatë që rezulton nga ndryshimet në çmimet relative. Ky nuk është një kufizim madhor nëse shikojmë ndryshimet për ushqim si total dhe jo mallrat individuale.

3 Së fundmi, kufizimet në të dhëna nuk na lejojnë të marrim parasysh prodhimin e ushqimit kështu që ne nuk përfshijmë ndikimet e mundshme pozitive të çmimeve të rritura të ushqimeve mbi prodhuesit neto të ushqimeve. Wodon et al. (2008) gjen që dallimi ndërmjet vlerësimeve të varfërisë me dhe pa prodhim është i vogël. Simulimet e bazuara në metodologjinë e Ivanic dhe Martin (2008), duke përdorur një paraqitje të detajuar të pjesës së prodhimit të familjeve në të dhënat e LSMS 2005 për Shqipërinë sugjerojnë që një rritje prej 5% në çmimet e ushqimeve sjell një rritje prej 1 pikë përqindjeje në praninë e varfërisë 2.5 US\$/ditë kur ana e prodhimit familjar nuk merret në konsideratë dhe 0.3 pikë përqindjeje kur merret parasysh, duke sugjeruar një bias në ngritje të ndikimit të varfërisë me rreth 0.7 pikë përqindjeje. Në pragu e varfërisë 5 US\$/ditë ky bias në ngritje llogaritet të jetë rreth 0.5 pikë përqindje.

Në Kosovë dhe Maqedoni simulimet sugjerojnë një rritje me 2 pikë të plota përqindjeje në varfëri, ndërkohë që në Bosnjë dhe Hercegovinë, Malin e Zi dhe Serbi simulimet sugjerojnë vetëm një rritje të kufizuar të varfërisë (Tabela 11). Rritja në rastet e varfërisë ka tendencë të jetë më e madhe në vendet ku varfëria ishte më e madhe që në fillim (Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni). Ajo është gjithashtu më e lartë për zonat rurale, ku varfëria ka gjithashtu tendencë të jetë më e lartë se në zonat urbane. Në Shqipëri, duke përdorur vijën e varfërisë 2.5 US\$/ditë, kjo përkthehet në 39,000 më shumë njerëz të varfër (60,000 nëse përdoret pragu 5 US\$/ditë) dhe në Kosovë, 18,000 më shumë (37,000 në pragu më të lartë të varfërisë). Vlerësimet për rritjen e rasteve në pragu e varfërisë 5 US\$/ditë janë më të njëtrajtshme në gjithë vendet e EJT, duke u luhatur nga 0.6 pikë përqindjeje në BiH deri në 2 pikë përqindjeje në Shqipëri.

Tabela 11: Ndryshimi i Simuluar në Varfëri nga një Rritje prej 5 Përqind në Çmimet e Ushqimeve (Pikë përqindjeje)

	2.5 US\$/ditë			5 US\$/ditë		
	Urban	Rural	Kombëtar	Urban	Rural	Kombëtar
Shqipëria	0,90	1,70	1,30	1,60	2,40	2,00
BiH	0,20	0,20	0,20	0,60	0,60	0,60
Kosova	1,70	2,70	2,30	1,00	1,20	1,20
Maqedonia	2,40	2,40	2,40	1,00	1,40	1,10
Mali i Zi	0,00	0,20	0,00	1,20	0,60	1,00
Serbia	0,20	0,30	0,20	1,20	1,60	1,30

Shënime: Vlerësimet bazë për 2010, përveç Shqipërisë (2008) dhe BiH (2007).


Përqindja më e madhe e ushqimeve në buxhetet e familjeve në pjesën e poshtme të shpërndarjes së mirëqenies sugjeron që këto familje do të preken më seriozisht nga çmimet më të larta se sa pjesa tjetër e popullsisë. Kjo është ilustruar në Figurën 50, e cila prezanton rritjen e simuluar në pikë përqindjeje të pjesës së ushqimit në buxhetet e familjeve për ata që janë në 30 përqindëshin e poshtëm të popullatës së çdo vendi, krahasuar me pjesën tjetër. Ky tregues kap atë se sa do të duhet të zhvendosin familjet në konsumin e tyre nga artikujt jo-ushqimorë tek ata ushqimorë nëse ata do të donin të konsumonin të njëjtën sasi ushqimi që konsumonin përpara rritjes së çmimeve. Në gjithë vendet e EJT, veçanërisht në Shqipëri, Maqedoni dhe Kosovë, ku prania e varfërisë është tashmë e lartë për 30 përqindëshin e poshtëm të popullatës, rritja në përqindjen e ushqimit në buxhet është 2.5 pikë përqindjeje ose më e lartë. Ndikimi diferencial është veçanërisht i madh në Kosovë dhe IRJ Maqedoni, ku pjesa e buxhetit llogaritet të rritet midis 3 dhe 4 pikë përqindjeje për 30 përqindëshin e poshtëm, dhe me 2.5 pikë përqindjeje për pjesën tjetër të popullatës.

Përveç rritjes së varfërisë, një rritje tjetër e fortë e çmimit të ushqimeve do të shkaktonte një barrë tjetër të konsiderueshme mbi të gjithë familjet, veçanërisht aty ku po rriten dhe çmimet e tjera. Megjithatë në këto simulime të varfërit janë gjithmonë më të prekur se sa jo të varfërit (të varfërit në Maqedoni are priten të humbasin deri 4.1 përqind të shpenzimeve totale, në Serbi 3.3 përqind, në Shqipëri 3.2 përqind, në Kosovë 3.1 përqind, në Malin e Zi 3.0 përqind dhe në BiH 2.7), humbja e fuqisë blerëse për jo të varfërit gjithashtu nuk është e neglizhueshme. Ajo arrin në 2.7 përqind të buxhetit familjar në Shqipëri dhe Maqedoni, 2.6 përqind në Kosovë, 2.3 përqind në Serbi dhe 2.1 përqind në Bosnjë. Ndikimi i këtyre rritjeve nuk do të ishte i papërfillshëm, pjesërisht për shkak se ato do t'i bashkoheshin ndikimit të rritjeve të tjera: disa vende të EJT po rrisin TVSH-në dhe akcizat për të zbutur buxhetet e tyre dhe çmimet e energjisë po rriten në disa vende.

Duket që ka një realitet të ri të paqëndrueshmërisë së lartë në çmimet e ushqimit, dhe rritjet e çmimeve kanë të ngjarë të vendosin një barrë të rëndë mbi buxhetet e familjeve që janë tashmë të dobësuar nga vite të rritjes ekonomike të ngadaltë. Kjo do të prekë në mënyrë të veçantë grupet më vulnerabël, saktësisht në momentin kur kufizimet makroekonomike mund të kufizojnë fushën e veprimtari të përgjigjeve politike.

Përshtatja me këtë paqëndrueshmëri të re do të kërkojë si masa afatshkurtra ashtu dhe afatgjata. Masat afatshkurtra përshijnë:


Figura 50: Ndryshimi në Pjesën e Buxhetit për ushqim për shkak të një rritjeje prej 5% në Treguesin e Çmimit të Ushqimeve (pikë përqindjeje)



Burimi: Vlerësimet e stafit të Bankës Botërore bazuar në të dhënat e studimeve të familjeve (Shqipëria LSMS 2008; BiH HBS 2007; të dhënat e HBS 2010 për Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë dhe Serbinë).

- (a) Qartësimi i tendencave në shfaqje, duke kuptuar mënyrën se si tendencat e cmimeve prekin të ardhurat e konsumatorëve dhe prodhuesve, nëpërmjet informacionit këshillues të ofruar nëpërmjet përpjekjeve shumëkombëshe (p.sh., Sistemi i Informacionit të Tregjeve Bujqësore të G20 - AMIS) ose nismave rajonale (p.sh. Qendra Euroaziatike për Sigurinë e Ushqimit, ECFS).
- (b) Dhënia e mbështetjes nëpërmjet rrjetave të sigurisë dhe programeve bujqësore (siç është ofrimi i farave/plehëruesve/foragjereve i financuar nga Programi Global i Përgjigjes ndaj Krizës së Çmimit të Ushqimeve (GFRP) për të mundësuar përgjigjen me ofertë në sistemet e të korrave dhe për të shmangur humbjen e stokeve në sistemet e blegtorisë). Duhet gjithashtu të merret parasysh përdorimi i matur i rezervave të mallrave.
- (c) Shmangja e subvencioneve për të korrat jo-ushqimore dhe ndalimeve të eksporteve që zmadhojnë çarjet e tregjeve globale dhe rajonale. Këto ndalime gjithashtu nuk janë masa efektive për të ulur çmimet e brendshme nëse vendet janë importues neto të mallrave që janë subjekt i ndalimit të eksportit.

Figura 51: Targetimi, mbulimi dhe sasia e ndihmës sociale nv Ballkanin Perëndimor



Burimi: Database e Ndihmës Sociale e Bankës Botërore dhe vlerësimet e Stafit të Bankës Botërore. *Shënim:* madhësia e rrethit tregon sasinë e mbështetjes së programit (% e konsumit të përgjithshëm familjar të përfituesve që mbulohet nga programi)

Masat afatmesme do të drejtoheshin ndaj investimeve të mëtejshme në rrjetat e sigurisë dhe sektorin bujqësor. Në rastin e bujqësisë, pavarësisht nga dallimet ndërmjet vendeve (siç është ekzistenca e një sektori bujqësor tregtar fillestar në Serbi), shfaqen një numër sfidash të përbashkëta. Këto sfida përfshijnë copëzimin e tokës ndërmjet një numri të madh të prodhuesve të vegjël të cilët mund të tregtojnë produktet e tyre ose në mënyrë informale ose me fuqi relativisht të vogël për të bërë ujdë krahasuar me tregtarët dhe me akses të kufizuar në kredi, ofrimi i pamjaftueshëm i të mirave publike si shërbimet e kërkimit dhe

ekstensionit, infrastruktura e tregut dhe menaxhimi i burimeve natyrore dhe nevoja për të reformuar mbështetjen bujqësore për fermerët për të ofruar stimuj për modernizim dhe për tu bërë efikas. Vetëm subvencionet nuk ka të ngjarë të ndihmojnë fermerët për të kapërcyer këto sfida.

Shumica e vendeve të EJT6 janë në pozicion të mirë për të zbatuar një axhendë të tillë. Pjesë të rrjetave të tyre të sigurisë janë relativisht të targetuara mirë (ndihma sociale si mjet i fundit, pagesat për fëmijët) dhe mund të shtrihen në mbulim apo sasi për të trajtuar pasojat e një tronditjeje të çmimit të ushqimeve. Megjithatë, sic tregohet në Figurën 51, ekziston një llojshmëri e konsiderueshme ndërmjet vendeve përsa i përket targetimit, mbulimit dhe sasisë.

Përparësitë për forcimin e sistemit do të ishin

- Vazhdimi i konsolidimit të programeve nëpërmjet integritit të pagesave për energjinë, pagesave për shërbimet, strehimin, etj. në një program të vetëm ndihme sociale si mjet i fundit (BiH, Mali i Zi dhe Serbi), ose bashkimi i programeve të ndryshme të copëzuara të ndihmës sociale si për shembull pagesa të shumëfishta për fëmijët (Maqedoni);
- Rritja e përqindjes së programeve të targetuara brenda sistemit të përgjithshëm të mbrojtjes sociale meqenëse këto programe janë të targetuara mirë por janë të vegjël për sa i përket mbulimit dhe marrjes.
- Bërja e sistemeve të targetuara më fleksibël për t'ju përgjigjur më mirë krizës. Gjatë viteve të krizës së 2009/10 programet e targetuara u përgjigjën por jo "automatikisht" (përveç rastit të Serbisë) meqenëse ato zakonisht kanë rregulla të dobët indeksimi dhe prandaj pragjet e pranueshmërisë në bazë të të ardhurave u gërryen me kalimin e kohës. Për të trajtuar këtë mungesë përgjigjeje Maqedonia futi përkohësisht shtesa për programin e saj të ndihmës sociale dhe Mali i Zi i rriti sasinë e ndihmës me 10 përqind.
- Rishikimi i strategjive kombëtare për monitorimin e mirëqenies dhe kushtet e jetesës për të siguruar monitorim të përshtatshëm në dritën e zhvillimeve të fundit në nxjerrjen e vlerësimeve të shpeshta të varfërisë (vëzhgime të shpejta, teknika të futjes së të dhënave nga një studim tek tjetri, modele mikro-simulimi)

Duke marrë parasysh përvojën e tronditjeve të kohëve të fundit dhe krizën globale, më poshtë janë disa rekomandime specifike sipas vendeve për një përgatitje më të mirë për kriza:

Shqipëria duhet të vazhdojë reformat e saj të kohëve të fundit për të forcuar pranueshmërinë për ndihmën sociale si mjet i fundit, sistemet e informacionit të menaxhimit dhe mbikëqyrjen. Monitorimi i rregullt i ndikimeve sociale minohet nga mungesa e të dhënave vjetore mbi varfërinë dhe shpërndarjen e saj.

Dy entitetet në BiH duhet të vazhdojnë përpjekjet e tyre për të përmirësuar targetimin e rrjetave të tyre të sigurisë dhe të bëjnë administratën e ndihmës sociale më efikase dhe transparente. Monitorimi i rregullt i ndikimeve sociale pengohet nga mungesa e të dhënave vjetore mbi varfërinë dhe shpërndarjen e saj.

Kosova, e cila ka një program të targetuar mirë por me mbulim të kufizuar të të varfërve, duhet të vazhdojë investimin në rritjen jo vetëm të sasisë për familjet e mëdha me fëmijë por edhe në zgjerimin e mbulimit të programit.

Maqedonia, e cila kishte një qëndrim pro-aktiv gjatë krizës së fundit globale në zgjerimin e mbulimit të rrjetave të saj të sigurisë, duhet të vazhdojë përpjekjet e saj për të harmonizuar dhe konsoliduar përfitimet dhe për të ngritur kapacitetin e rrjetës së sigurisë për të mbrojtur familjet e varfra në kohë krize.

Subvencionet bujqësore të tanishme në rritje synojnë rritjen e produktivitetit të sektorit dhe eksportet e prodhimeve bujqësore por ka mundësi të jenë një mënyrë inefficente për të mbrojtur familjet më të varfra nga ndikimet e rritjeve të çmimit të ushqimeve.

Mali i Zi, i cili gjatë krizës së kaluar ka rritur buxhetin e orientuar drejt ndihmës sociale por ka një prag mjaft të ngurtë për pranueshmërinë në programin e mjetit të fundit, duhet të trajtojë mungesën e fleksibilitetit në program (dhe të pagesave të fëmijëve të cilat janë të lidhura me programin kryesor) në kohë krize.

Serbia ishte pro-aktive gjatë tronditjeve të fundit të ushqimit duke kërkuar moderimin e çmimeve të ushqimeve nëpërmjet ndalimit të eksporteve, por këto duket të kenë gjetur pak sukses²⁰, ndërkohë që ndihma e saj sociale si mjet i fundit vazhdoi në tendencën e saj afatgjatë të zgjerimit të mbulimit. Për të bërë më efektive përgjigjet ndaj një tronditjeje ushqimore, përpjekjet për rritjen e fleksibilitetit të sistemit të ndihmës sociale duket të kërkojnë të përmirësojnë si mbulimin e të varfërve dhe madhësinë e përfitimeve, në përputhje me reformat e fundit.

²⁰ Në vitin 2007/2008 Serbia u mbështet mbi një kombinim të ndalimit të eksporteve dhe rezervat strategjike për të shmangur një rritje në çmimin e ushqimeve por çmimet për miellin e grurit, bukën dhe produktet e tjera të përpunuara u ngritën përsëri (Djuric et al. 2010). Masa të ngjashme u futën në vitin 2011 dhe përsëri në 2012. Për shkak të thatësirës së verës, masat e Gushtit 2012 përfshinë gjithashtu një paketë të masave të ndihmës (subvencione për karburante dhe kredi, heqja e pagesave për ujtitjen).

REFERENCAT

Baffes, John and Bruce Gardner. 2003 “The Transmission of World Commodity Prices to Domestic Markets Under Policy Reforms in Developing Countries.” *Journal of Policy Reform* 6(3): 159–80.

Djuric, Ivan, Linde Gotz, and Thomas Glauben. 2011 “Influences of the Governmental Interventions on Wheat Markets in Serbia during the Food Crisis 2007/2008.” Halle, Germany: Leibniz Institute of Agricultural Development in Central and Eastern Europe (IAMO).

Headey, Derek, and Shenggen Fan. 2011 “Reflections on the Global Food Crisis: How Did It Happen? How Has It Hurt? And How Can We Prevent the Next One?” IFPRI Research Monograph No. 165. Washington, DC: International Food Policy Research Institute.

Ivanic, Maros, and Will Martin. 2008 “Implications of Higher Global Food Prices for Poverty in Low-Income Countries.” Policy Research Working Paper No. 4594. Washington, DC: Grupi i Bankës Botërore

Townsend, Robert, Sergiy Zorya, Iride Ceccacci, Saswati Bora and Christopher Delgado 2011. *Responding to Higher and More Volatile World Food Prices*. Washington, DC: Agriculture and Rural Development, World Bank Group.

Wodon, Quentin, Clarence Tsimpo, Prospere Backiny-Yetna, George Joseph, Franck Adobo, and Harold Coulombe. 2008 “Potential Impact of Higher Food Prices on Poverty: Summary Estimates for a Dozen West and Central African Countries.” Policy Research Working Paper No. 4745. Washington, DC: Grupi i Bankës Botërore

Banka Botërore 2010 *Lights out? The Outlook for Energy in Eastern Europe and the Former Soviet Union*. Washington, DC: Grupi i Bankës Botërore